

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË Durrës

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Durrës**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më 31.12.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 75, datë 30.06.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1206/9, datë 30.06.2015, i ka rekomanduar z. Vangjush Dako, Kryetar i Bashkisë Durrës, zbatimin e masave të mëposhtme:

A.MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetje: Bashkia Durrës nuk ka zbatuar rekomandimet e kontrollit të KLSH-së, dërguar me shkresën nr. 197/8 Prot, datë 30.06.2013 dhe të rikërkua nga KLSH me shkresën nr. 1016/27, datë 30.6.2014, që ka sjellë si pasojë mos vjeljen, mosvënien e kërimit në rrugë ligjore të dëmit të shkaktuar buxhetit të shtetit nga keq menaxhimi i Njesisë, në vlerën totale prej **109,776,669 lekë**, nga të cilat: për 10 masa zhdëmtuese me vlerën 57,610,789 lekë ndaj 8 subjekteve e 7 personave, për 3 masa organizative me vlerën 52.165,880 lekë ndaj 37 subjekteve dhe 1 masë administrative për 500,000 lekë si dhe nuk ka zbatuar e 6 masa organizative. Mosveprime këto në kundërshtim me nenin 15, germa “gj”, ”j” dhe “k” të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” .

1. Rekomandim: Bashkia Durrës, Kryetari, të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën nr. 197/8 Prot, datë 30.06.2013, dhe të rikërkua nga KLSH me shkresën nr. 1016/27, datë 30.6.2014.

Menjëherë

2 Gjetje: Bashkia Durrës për vitet 2013-2014 ka mangësi, shkelje, pamjaftueshmëri pune e kapacitetesh, lidhur me ndjekjen e hapave për instalimin, vendosjen, zbatimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, mbajtjen evidentimin e ndjekjen e dokumentacionit përkatës shprehur me: Mungesa të dokumentacionit për hapat e ndjekur dhe instalimin e MFK lidhur me; -Mungon dhe nuk është përcaktuar dokumenti i “Deklarata e Misionit, vizionit dhe i objektivave Themelore të aktivitetit”, dokument i cili do të pasqyrojë në mënyrë të qartë, koncize, Misionin, Vizionin dhe në mënyrë të matshme e krahasueshme, treguesit kryesor të arritur për objektivat themelor të aktivitetit të Bashkisë Durrës për vitet 2013 dhe 2014;

-Mungon dhe nuk ka ndonjë dokument për analizën dhe raportimin e realizimit të treguesve të parashikuar dhe të monitoruar të objektivave themelor të aktivitetit për Bashkinë Durrës në secilin prej viteve 2013 dhe 2014; ekzistenca e të cilit do të krijonte mundësinë, për audituesin por edhe për publikun, të dhënies së një opinionit, vlerësues lidhur me arritjen e objektivave për secilin prej viteve 2013 dhe 2014 dhe ndoshta dhe për periudha të mëparshme progresive;

-Mungon “Strategjia e menaxhimit të risqeve” dhe “Regjistri i riskut” që pengojnë realizimin e objektivave kryesore njëkohësisht dhe në hartimin e zbatimit e Plan Buxhetit dhe Plani i Veprimit Afatmesëm për rishikimin e sistemeve të brendshme të kontrollit dhe përgatitjen e gjurmëve të auditit për procedurat specifike të institucionit;

-Mungojnë përcaktimi nga titullari i procedurave të brendshme të antikorrupsionit dhe sinjalizimit të parregullsive;

Mungojnë përshkrimi dhe miratimi i proceseve dhe veprimeve, lidhur me qarkullimin e dokumentacionit shkresor, përfshirja dhe normimi e tyre në rregulloret përkatëse; mungesa këto në mospërmbushje të neneve 8, germa “e”,17,19-22 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Manualin “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” shtojcat përkatëse 6, 7 etj, miratuar me urdhrin nr. 54, datë 15.7.2010 dhe të udhëzimit nr 30, datë

27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. Mangësi në dokumentacion të evidentimit, ndjekjes e raportimit;

Plani Strategjik SZHE me shtrirje kohore 2005 deri në vitin 2015, të cilit i mbaron afati, ka pasur mangësi pasi burimet e financimit nuk rakordojnë, dhe është i pa mbuluar dhe nuk mobilizon burimet nga buxheti i Bashkisë për shumën 6,575,600,000 lekë, si dhe mungojnë e nuk raportohen treguesit e monitorimit ndjekjes dhe raportimit të realizimit sipas matricave b, c, d, e, pra realizimi i treguesve të matricave: Matrica e Qëllimeve, objektivave, programeve dhe projekteve të planit; c. Matrica e zbatimit të planit; d. Matrica e prioritarizimit të projekteve; dhe e. Fishat e projekteve, për secilin prej viteve 2013 dhe 2014 dhe progresiv prej fillimit që ka sjellë si pasojë mungesën dhe mos kryerjen e korrektimeve dhe ndryshimeve eventuale nga monitorimi. Plan-veprimet afatmesme dhe vjetore, nuk janë hartuar pra ka munguar për pasojë dhe ndjekja e zbatimi i strategjisë dhe mbi të cilat hartohen e zbatohen buxhetet përkatëse

Ngritja dhe funksionimi i “Grupi i Menaxhimit Strategjik”(GMS), është i parregullt pasi nuk përcaktojnë funksione detyrat e afatet, raportimin etj, si dhe ka munguar nuk dokumentohet e raportohet puna e (GMS), Grupeve për Strategji, Buxhet dhe Integrim (GSBI), Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP), Drejtoritë e Menaxhimit të Programeve (DEMP) mangësi kjo, në mospërmbushje të nenit 27 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 dhe të detyrimeve të Kryetarit të Njësisë së Qeverisjes Vendore (sipas Aneksit 2 të Udhëzimit nr. 20, datë 26.02.2009, “Për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe fondet speciale”.

Raporti Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm vitet 2012 dhe 2013 janë plotësuar në mënyrë të pasaktë me mungesa plotësimi të komponentëve dhe mungesa plotësimi në brendi, duke mos respektuar formën standarde me pasojë mosparaqitje me besueshmëri të realitetit për vendosjen dhe funksionimin e Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) gjendje raportuese kjo në kundërshtim me Kapitullin e III “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, nenet 19-24 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” me orientimet e Manualit “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” të miratuar nga MF me Urdhër nr.54, datë 8.7.2010, dhe me udhëzimin nr.28, datë 15.12.2011” Mbi Paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë Publike”.

Pyetëtori i vetëvlerësimit të funksionimit të SMFK për vitin 2012 dhe 2013, është plotësuar në mënyrë të pa plotë në rubrika, shpesh mungojnë komentet dhe dokumentet bashkëlidhur tij, me mangësi dhe pasaktësi në rubrikat e plotësuar, si dhe vlerësime me tepëri që tregon se pyetëtori nuk pasqyron me vërtetësi realitetin e vlerësimit të gjendjes së sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në kundërshtim me nenet 17 dhe 29 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, nenit 18 të ligjit 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe udhëzimin nr.28, datë 15.12.2011.

2.1 Rekomandim: Bashkia Durrës të marrë masa për rritjen e kapaciteteve dhe ndjekjen e hapave për instalimin, vendosjen, zbatimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, si dhe të hartojë miratojë monitorojë e zbatojë dokumentacionin e munguar: “Deklarata e Misionit, vizionit dhe i objektivave Themelorë të aktivitetit”, “Raportimin e realizimit të treguesve të parashikuar dhe të monitoruar të objektivave themelor të aktivitetit”, “Strategjia e menaxhimit të risqeve” dhe “Regjistri i riskut” që pengojnë realizimin e objektivave kryesore, hartimin e zbatimin e Plan Buxhetit; “Plani i Veprimi Afatmesëm për rishikimin e sistemeve të brendshme të kontrollit dhe përgatitjen e gjurmëve të auditit për procedurat specifike të institucionit”; dokumentim “Përcaktimi nga titullari i procedurave të brendshme të antikorrupsionit dhe sinjalizimit të parregullsive”; ”Përshkrimi dhe miratimi i proceseve dhe veprimeve, lidhur me qarkullimin e dokumentacionit shkresor, përfshirja dhe normimi në rregulloret përkatëse”.

Deri me 30 Nëntor 2015

2.2 Rekomandim: Bashkia Durrës, kryetari të marrë masa për Ngritjen dhe funksionimin e Strukturave të MFK si “Grupi i Menaxhimit Strategjik”(GMS), dhe të strukturave të tjera si Grupi për Strategji, Buxhet dhe Integrim (GSBI), Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP),

Drejtoritë e Menaxhimit të Programeve (DEMP) dhe të përcaktojnë qartësisht funksionet detyrat e afatet, raportimin dhe monitorimin etj, si dhe të kërkojë dokumentimin e raportimin e vashdueshëm të punës së strukturave të mësipërme.

Menjëherë dhe vazhdimisht

2.3 Rekomandim: Bashkia Durrës resurse e pasuri të konsiderueshme për zhvillim progresiv, të marrë masa të hartojë Planin Strategjik SZHE të ri, pasi SZHE aktual i ka përfunduar afati, duke përfshirë “Planin e Përgjithshëm Vendor” (PPV), (tashmë të miratuar) dhe përfshijë e marrë në konsideratë të gjitha resurset, veprimtaritë e aktivitetet e munguara dhe të papërfshira më parë (resurset bujqësore, pyjet, ujërat, florën, faunën, dhe aktivitetet e lidhura me to industrinë bujqësinë, peshkimin, turizmin, pylltarinë, gjuetinë etj. të hartojë, monitorojë e raportojë strategjitë e Plan-veprimet afatmesme dhe vjetore, mbi të cilat hartohen e zbatohen buxhetet përkatëse.

Deri me 30 Nëntor 2015

2.4 Rekomandim: Bashkia Durrës të marrë masa të hartojë, përgatisë dhe raportojë “Raporti Vjetor për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm” dhe “Pyetësori i vetëvlerësimit të funksionimit të SMFK”, në mënyrë të plotë e të saktë për çdo rubrikë e komponent në përputhje standardet në forme e përmbajtje me synim paraqitjen e realitetit me besueshmëri maksimale dhe të përmbushjes të funksionit për ti shërbyer ndjekjes së hapave për instalimin, vendosjen, e zbatimin e Menaxhimit Financiar dhe kontrollit si dhe efikasitetit të Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) në këtë Njësi Publike.

Deri me 30 Nëntor 2015

3 Gjetje: DAB dhe Bashkia Durrës, pas kryerjes së auditimit Nd/je Parkut Eksportit Durrës, nuk kanë rekomanduar tek Titullari apo dhe kërkuar vetë nga DAB e Bashkisë pranë ZVRPP Durrës, dokumentacionin dhe procesverbalin e dorëzimit të pronës të sipërfaqes prej 4200 m² nga pronari posedues Bashkia, sikundër shprehur në raportin e auditimit të disponuar ku përmendet se kjo pronë është e regjistruar me Regjistrin Hipotekor nr.8, datë 22.01.2003, pra nuk është kërkuar zbatimi i plotë i procedurave dhe dokumentacionit shoqërues të Regjistrit hipotekor të përmendur, dhe mungesa e procesverbalit të dorëzimit, nuk lejon të drejtën e zotërimit nga person tjetër sakohë prona është nën administrim shtetëror, mosveprim në kundërshtim me ligjin nr. 843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ndryshuar me ligjin nr 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe me rregulloren nr.184, datë 18.4.1999 “Për punën në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” me ndryshimet.

3 Rekomandimi: Bashkia Durrës, Nd/je Parkut Eksporti Durrës dhe DAB pas auditimit të ushtrojnë të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore të marrë e vënë nën administrim 4200m² truall dhe ndërtesa pronë e Nd/jes Parkut Eksportit të identifikojë verifikojë dhe kërkojë pranë ZVRPP Durrës dokumentacionin lidhur me Regjistrin Hipotekor nr. 8, datë 22.01.2003, procesverbalin e dorësimit të pronës dhe zbatimin e plotë të procedurave ligjore të përfitimit dhe dorëzimit në zotërim të qytetari dhe dokumentacionit shoqërues të titullit të pronësisë të regjistruar në hipoteke sipas regjistrit hipotekor nr.8. datë 22.01.2003.

Menjëherë

4 Gjetje: Bashkia Durrës, DAB në auditimin e NTSH Durrës, nuk ka trajtuar e sqaruar në mënyrë të qartë detyrimet të 3 debitorëve nga qiratë e pa likuiduara në afat dhe të debitorëve të tjerë përmendur sipas tabelës në faqe 2 të Raportit Final përgatitur nga auditimi, paqartësi kjo që rrjedh nga mos auditimi i monitorimit dhe rregullshmërisë të lidhjes së kontratave të qirasë, hartimi i kontratave–Tip, përfshirja ose jo e sanksioneve lidhur me detyrimet ndërmjet palëve, përditësimi dhe ndryshimi konformë ndryshimit të VKM-ve, llogaritja e detyrimit të Kamatëvonesave etj, në kundërshtim me Kreun VI “Monitorimi i Kontratës”, të VKM nr. 529, datë 8.6.2011 dhe VKM nr. 54, datë 5.2.2014, për secilin prej tre viteve dhe prej fillimit të cenimit dhe apo lidhjes së kontratave.

4 Rekomandimi: Bashkia Durrës dhe DAB në bashkëpunim Nd/jet e vartësisë të kryejë auditimin e monitorimit të Kontratave të qirasë të lidhura, rregullshmërisë të lidhjes së kontratave të qirasë, hartimin i kontratave–Tip, përfshirjen e sanksioneve lidhur me detyrimet ndërmjet palëve, përditësimi dhe ndryshimi konformë ndryshimit të VKM-ve, si dhe të bëhet llogaritja e detyrimit të Kamatëvonesave etj, dhe të kërkojë likuidimin e menjëhershëm të qirasë së papaguar me kamatëvonesat në zbatim të Kreut të VI “Monitorimi i Kontratës”, të VKM nr. 529, datë 8.6.2011 dhe VKM nr. 54, datë 5.2.2014, për secilin prej tre viteve dhe prej fillimit të cenimit dhe apo lidhjes së kontratave ,

Menjëherë dhe vazhdimisht

5 Gjetje: DAB e Bashkisë Durrës ka performancë të pamjaftueshme pune reflektuar në vendosjen aplikimin e SKB dhe mekanizmave të MFK dhe mangësi, pamjaftueshmëri në auditimet e kryera në periudhën 2013-2014 lidhur me rregullshmërinë, zbatimin e standardeve të auditimit, gjetjet rekomandimet dhe administrimin dosjeve të auditimit pasi nga auditimi me zgjedhje i 5 dosjeve të auditimit nga të cilat 3 dosje auditimi të kryera në Nd/je vlerësuar me risk të lartë, dhe 2 dosje auditimi për zbatimin e rekomandimeve në 18 entitete (nga të cilat 11 për vitin 2013 dhe 7 për vitin 2014), rezultojnë mangësi lidhur me thellimin dhe çuarjen deri në fund të çështjeve të audituara, formulimin e saktë të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve, mangësi pasaktësi në trajtimin përgatitjen formulimin dhe cilësimin e bazës mbështetëse ligjore e nënligjore të gjetjeve, trajtimin e sqarimeve dhe observacioneve të cilat kanë bërë sjellë përgatitjen e projektraporteve dhe Raporteve final më cilësi të pamjaftueshme; mangësi në planifikimin e auditimit dhe në ndarjen e çështjeve ndërmjet anëtarëve të grupit të audituesve për çdo mision auditimi të angazhuar; mosadministrim i rregullt i dokumentacionit të dosjeve lidhur me mungesën e inventarizimit me numër për çdo fletë dokumenti, dhe mos dorëzim i tyre në arkivë në fundviti pas kryerjes auditimit të zbatimit të rekomandimeve, gjendje kjo; në moszbatim e shkelje të procedurave të auditimit të brendshëm në kundërshtim me ligjin nr. 9720, datë 24.4.2007”Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010 ”Për disa shtesa e ndryshime të ligjit nr. 9720”dhe me VKM nr. 345, datë 01.06.2004 “Manuali i Procedurave të Auditimit, për të cilat Struktura e DAB ka detyrimin dhe ka dhënë sigurinë,dhe transparencë për auditimet e kryera, gjë që e ngarkon me përgjegjësi .

5 Rekomandim: Bashkia Durrës, Kryetari dhe DAB të analizojë pamjaftueshmërinë e performancës së punës Audituese në vitet 2013-2014 të nxjerrë përgjegjësitë, të marrin masat lidhur me vendosjen aplikimin e SKB dhe mekanizmave MFK, lidhur me rregullshmërinë, në zbatimin e standardeve të auditimit, gjetjet rekomandimet dhe administrimin dosjeve të auditimit lidhur me mos thellimin dhe mos çuarjen deri në fund të çështjeve të audituara, formulimin e saktë të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve, trajtimin përgatitjen formulimin dhe cilësimin e bazës mbështetëse ligjore e nënligjore të gjetjeve, trajtimin e sqarimeve dhe observacioneve e rritjen e cilësisë në përgatitjen e projektraporteve dhe Raporteve final të auditimit, në planifikimin e auditimit dhe në ndarjen e çështjeve ndërmjet anëtarëve të grupit të audituesve për çdo mision auditimi të angazhuar; dhe të kryejë inventarizimin me numër për çdo fletë dokumenti, e të dorëzojë dosjet në arkiv në fundviti pasi të jetë kryer auditimi i zbatimit të rekomandimeve; me synim rritjen e performancës, efikasitetit dhe transparencës së punës së DAB.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

6 Gjetje: Bashkia Durrës ka pamjaftueshmëri pune e performance në ndjekjen dhe realizimin e buxhetit ku për vitin 2013, niveli i realizimit është 72,3% ose realizuar 1,102,657 mijë lekë kundrejt 1,525,657 mijë lekë me mosrealizim prej 422,979 mijë lekë, ndërsa në vitin 2014 niveli i realizimit është 76,7% ose realizuar 1,392,431 mijë lekë kundrejt 1,814,731 mijë lekë me mos realizim 422,300 mijë lekë; gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr.119/2012, datë 17.12.2012, “Për buxhetin e vitit 2013”, dhe me ligji nr.185/2013, datë 02.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”

6 Rekomandim: Bashkia Durrës të marrë masat për ndjekjen dhe zbatimin e buxheteve vjetore duke vlerësuar si pjesën e buxhetit të vetë ashtu dhe atë të buxheti Qendror.

Vazhdimisht

7 Gjetje: Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Durrës, nuk ka plotësuar pasqyrat nr. 10, “Pasqyrë e konsoliduar e gjendjes financiare” dhe pasqyra nr. 11, “Pasqyrë e konsoliduar e të ardhurave e shpenzimeve të funksionimit”, në kundërshtim me Udhëzimi i Ministrisë së Financave (UMF) nr. 26, datë 27.12.2007, “Për disa shtesa e ndryshime në UMF nr. 14, datë, 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë dhe njësitë që varen prej tyre”, i ndryshuar.

7 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike, të marrë masa për azhurnimin e pasqyrave të bilancit nr. 10, “Pasqyrë e konsoliduar e gjendjes financiare” dhe pasqyrës nr. 11, “Pasqyrë e konsoliduar e të ardhurave e shpenzimeve të funksionimit”, për vitet 2013 e 2014.

Deri datën 30 Nëntor 2015

8 Gjetje: Drejtoria Ekonomike në llogarinë nr. 202, “Studime dhe kërkime”, ka pasqyruar me pozicion financiar 140,406,613 lekë në bilancin e vitit 2013, që i përket vlerës së studim projekteve të mbartur prej vitesh dhe amortizimit të tyre të pasqyruar në llogarinë nr. 209, “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara”, me vlerë 130.193.303 lekë, ndërsa vlera 140.406.613 lekë (që ju përket shumë viteve) nuk është përfshirë në rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara. Gjithashtu dhe vlera e mbikëqyrjes dhe e kolaudimeve (që ju përket shumë viteve, nuk është përfshirë në vlerën e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara).

Këto veprime bien në kundërshtim me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika “c”, nën pika “b”, ku përcakton se: “Në strukturën e investimeve dhe të ndërtimeve themelore, përveç punimeve të ndërtim montimit përfshihen edhe: Studime e projekte, duke filluar nga studimi i domosdoshmërisë dhe leverdishmërisë së ndërtimit të veprës, deri në mbikëqyrjen e kolaudimit përfundimtar të saj”.

8 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike, të sistemojë në aktivet e qëndrueshme të trupëzuara, vlerën 140.406.613 lekë, e pasqyruar në llogarinë nr. 202, “Studime dhe kërkime” me pozicion financiar 140.406.613 lekë, në bilancin e vitit 2013, që përfaqëson studime dhe projekte të mbartura prej vitesh. Njëkohësisht të sistemojë dhe amortizimin mbajtur gjendje në llogarinë nr. 209, “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara”, me vlerë 130.193.303 lekë, në amortizimeve të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara. Gjithashtu të sistemohen në aktive të qëndrueshme shpenzimet e kryera për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit, duke kryer rakordimet përkatëse me njësitë vartëse.

Deri në datën 30 Nëntor 2015

9 Gjetje: U konstatuan mangësi në plotësimin dhe përpunimin e dokumentacionit të arkës:

Prej vitesh nuk është plotësuar libri i arkës për çdo ditë pune, në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika nr. 67.

Theksojmë se proceset dhe operacionet e punës, për pozicionin e arkëtarit, nuk janë përfshirë në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë, të miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 67, datë 23.03.2006

9. Rekomandim: Drejtoria Ekonomike, të marrë masa dhe të fillojë menjëherë plotësimin e librit të arkës në rrugë kronologjike dhe për çdo ditë pune. Operacionet dhe proceset e punës së arkëtarit të përfshihen në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë.

Menjëherë

10 Gjetje: Drejtoria Ekonomike, Sektori i Financës, në vitet ushtrimore 2013 dhe 2014, nuk ka respektuar numrin rendor me rend rritës (progresiv) në plotësimin e fletë hyrjeve dhe fletë daljeve të magazinës, konkretisht:

Në vitin 2013, u konstatuan numra rendor për fletë hyrjet nga 1- 29, duke përsëritur numrat 1-7 dhe 1-6, ndërsa fletë daljet nga numri 1-439, duke përsëritur nga 1-47. Gjithashtu ditarët e kontabilitetit të magazinës janë plotësuar më vete sipas numrave rendorë të cilët janë përsëritur. Edhe për vitin 2014, është përsëritur e njëjta parregullsi e ndjekur e njëjta procedurë. Me urdhër shpenzimi nr. 536, datë 07.11.2014, me vlerë 17,660 lekë, me objekt “Riparim fotokopje canon”, kryer nga “Albital Canon” shpk, është prerë hyrja nr. 29, datë 29.10.2014, në kundërshtim me

pikën nr. 37, të UMF nr. 30, datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pasi është kryer shërbim dhe hyrje bëhen mallrat .

10 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike të marrë masa për respektimin e numrit rendor (progresiv) të dokumenteve të magazinës dhe të azhurnojë në ditar të veçantë hyrjet dhe në një ditar tjetër daljet, duke eliminuar praktiken e deritanishme të mbajtjes së disa ditarëve; si dhe të kryhet veprimi kontabël për sistemimin, anulimin e fletë hyrjes nr. 536, datë 17.11.2011, me vlerë 17.600 lekë.

Menjëherë

11 Gjetje: Drejtoria Ekonomike, sektori i financës nuk ka kryer regjistrimet në kontabilitet dhe nuk ka pasqyruar në bilancet kontabël shtesat në aktivet e qëndrueshme të trupëzuara të marra në dorëzim nga Bashkia në vlerën 339.121.126 lekë, ndërkohë që njësitë vartësi kanë të regjistruar vlerën 250.790.508 lekë, me një diferencë në shumën **88.230.618 lekë**, që i përkasin për tju shpërndarë e marrë nw evidencë proporcionalisht sipas vlerave njërive: Ndërmarrje Rruga, pasqyruar vlerën 6,832,751 lekë në llogarinë nr. 213, ”Rrugë rrjete e vepra ujore”, Ndërmarrje Shërbimeve Komunale, në llogarinë nr. 212, “Ndërtesa” në vlerën 58,345,913 lekë, dhe Qendra Ekonomike e Arsimit, vlerë 185.611.844 lekë; gjendje kjo në kundërshtim me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, “Për disa shtesa e ndryshime në UMF nr. 14, datë, 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendorë dhe njësitë që varen prej tyre”.

11 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike, sektori i financës të kryejë rakordimin me njësitë vartëse dhe të sistemojë në kontabilitet aktivet e qëndrueshme që përkasin diferencës së pa përfshitë në shumën 88.230.618 lekë nga investimet, e kryera në objektet e dorëzuara nga Bashkia - Njërive vartëse gjatë vitit 2013.

Deri në datën 30 Nëntor 2015

12 Gjetje: Bashkia Durrës, gjatë vitit 2013 ka zhvilluar gjithsej 15 procedura prokurimi me fond limit 208,970,884 lekë. Nga këto, ka anuluar dy procedura me fond limit 25,475,717 lekë, ka realizuar 13 procedura me fond limit 183,495,167 lekë, dhe ka lidhur 13 kontrata zbatimi me vlere te përgjithshme 134,489,211 lekë. Ne përgjithësi, u konstatua se, llogaritja e vlerës së kontratave (fondi limit) për punë është bërë në bazë të çmimeve të përcaktuar në manualet teknike të ndërtimit të miratuara me VKM dhe për ato zëra që nuk janë përfshirë në këto manuale u është referuar analizave teknike të çmimeve të tregut. Mirëpo, po ti referohemi kontratave për punë të realizuara në vitet e mëparshme nga vetë ky Autoritet Kontraktor disa çmime të zërave të punës të këtyre kontratave si pasojë e konkurrencës dalë nga zbatimi i procedurave të prokurimit janë rreth 30% më të ulta se, çmimet e përcaktuara në manualet e ndërtimit. Nisur nga kjo Autoriteti Kontraktor duhet ti referohej çmimeve të kontratave të mëparshme dhe jo çmimeve të manualeve të ndërtimit.

12 Rekomandim: Për përlllogaritjen e vlerave të kontratave duhet të merren në konsideratë, çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga vete Autoriteti Kontraktor kur ato janë më të ulta se çmimet e manualeve.

Vazhdimisht

13 Gjetje: Për 4 prokurime me vlerë mbi 100 milion lekë secili, me fond limit total 751,450,468 lekë, për objektet “Rikualifikimi i Nënkalimit dhe Rotondës tek Ura e Dajlanit dhe në Plepa Durrës”, “Ndërtim i rrugës së re paralel me murin e Portit”, “Rikualifikim i sheshit “Iliria”, (sheshi “Liria” faza II)”, “Realizimi i korsive të biçikletave, gjelbërimit dhe ndriçimit në rrugën “Pavarësia”, nuk ka kryer opionencë teknike, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 6; paraqitur analitikisht në tabelën emërtuar “Procedura tenderi të kryera pa opionencë teknike” .

13 Rekomandim: Bashkia Durrës, të marrë masa për të kryer opionencën teknike të projekteve teknike për secilin objekt me fond limit mbi 100 milion lekë, në zbatim të ligjit me synim rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve.

Vazhdimisht

14 Gjetje: Për 13 objekte me vlerë 727.779.690 lekë, prokuruar në vitin 2014, me procedurë “Tender i hapur për punime ndërtimi”, grupi i hartimit të fondit limit dhe specifikimeve teknike, ka përcaktuar kriterin e kategorisë së licencës duke e kufizuar vetëm për kategorinë e punimit, pa përcaktuar klasifikimin e subjekteve juridik/fizik në nivele për çdo kategori punimesh, në kundërshtim me VKM nr.42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, që ka sjellë si pasojë deformimin e pjesëmarrjes, paraqitur analitikisht në tabelën emërtuar “Kategoritë e kërkuara të licencës sipas objekteve të audituara”. Në këtë mënyrë ky kriter është bërë pjesë e dokumenteve të tenderit.

-Po për këto 13 objekte prokurimi, në strukturën e preventivit të llogaritjes së fondit limit, nuk është parashikuar e vendosur vlera prej jo më pak se 3% e vlerës së projektit, zëri “për sigurinë në kantier”, që ka sjellë llogaritjen e fondit limit në vlerë më të ulët për shumën 21.833.391 lekë, me pasojë cenimin e garancisë së mbrojtjes dhe sigurisë në punë, mosveprim në kundërshtim me VKM nr. 664, datë 26.09.12, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 514, datë 15.8.07, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10.

-Në hartimin e specifikimeve teknike për llogaritjen e fuqisë punëtore dhe mjeteve, për mbulimin e volumeve të punës, nuk ka argumentim, mungesë kjo në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.07, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu III, “Dokumentet e Tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, nënpika “a”, “Kontratat për punë”.

14 Rekomandim: Bashkia Durrës të marrë masa të vazhdueshme në përcaktimin e saktë të kriterëve dhe kërkesave teknike për kualifikim të Operatorëve të tregut, me synim mos deformimin e tregut, dhe konkurrencës, për përfshirjen në hartimin e preventivave, për llogaritjen e parashikimin e fondit të nevojshëm për sigurinë e mbrojtjen në punë të punëmarrësve si dhe të argumentojë llogaritjen e fuqisë punëtore dhe mjeteve, të nevojshme për mbulimin e volumeve të punës në realizimin e objektit.

Vazhdimisht

15 Gjetje: Për 13 objekte me vlerë 727.779.690 lekë prokuruar në vitin 2014 me procedurë “Tender i hapur për punime ndërtimi”, grupi i hartimit të fondit limit dhe specifikimeve teknike, në hartimin e preventivave të punimeve të ndërtimit, nuk ka respektuar manualët për analizat teknike të çmimeve, mosveprim që ka sjellë si pasojë mosllogaritje të saktë të fondit limit rrjedhur nga çmime të vendosura më të ulta se manuali në shumën - 95.433.978 lekë dhe çmime të vendosura mbi manual në shumën + 52.691.235 lekë; pra ka sjellë efekt ekonomik negativ me rritjen artificiale të fondit limit në vlerën + 52.691.235 lekë dhe që vjen në kundërshtim me VKM nr. 568, datë 27.06.13, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, VKM nr. 514, datë 15.08.07, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, VKM nr. 664, datë 26.09.12, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 514, datë 15.8.07 të KM”, pikat 2, 3, 4, 5, 17, dhe VKM nr.1, datë 10.01.07, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu III, “Dokumentet e Tenderit”, pika 3 “Informacione të veçanta”, nënpika “a” Kontratat për punë”, paraqitur analitikisht në tabelën emërtuar “Diferencat e çmimeve të preventivit të fondit limit të AK me manualët e miratuara”.

15.1 Rekomandim: Bashkia Durrës të marrë masa që në hartimin e preventivave të bazohet në manualët zyrtarë të analizave teknike të çmimeve dhe të respektojë ato, duke shmangur rritjen artificiale të fondit limit me pasojë uljen e efektivitetit të përdorimit të fondeve dhe deformimin e konkurrencës së operatorëve në treg.

15.2. Rekomandim: Bashkia Durrës të marrë masa që grupet e hartimit të fondit limit në hartimin e preventivave të hartojnë strukturën e kostos mbështetur në manualët teknike.

Vazhdimisht

16. Gjetje: Grupi i hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT), për tre procedura prokurimi, në kërkesat e specifikimeve

teknike për realizimin e objektit: “Rikonstruksion i segmentit “Bulevardi Dyrrah – Sheshi Liria”, “Rikualifikim Fasdash”, “Rikualifikim Fasdash” ka përcaktuar si kërkesë për t’u vendosur në kriteret e kualifikimit paraqitjen e autorizimit nga prodhuesi i shoqëruar me certifikatë ISO, pa përcaktuar se çfarë certifikate ISO kërkohet, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.06, i ndryshuar, “Për prokurimin publik”, neni 23, “Specifikimet teknike”. Në tenderin me objekt, “Rikualifikim Fasdash” kjo certifikatë është kërkuar për procese pune dhe jo për prodhimin e llojit të bojës, në kundërshtim me qëllimin e kërkesës, kriteri i cili ka ndikuar në s’kualifikimin e OE, në këto procedurë për s’kualifikim nga procedurat edhe për këtë arsye.

16. Rekomandim: Bashkia Durrës të marrë masa që kriteret kualifikuese të përcaktohen qartë dhe saktë lidhur me përcaktimi e llojit certifikatës në përputhje me prodhuesin.

Vazhdimisht

17. Gjetje: Kryetari i KVO-së, në procedurat të prokurimit “Bulevardi Dyrrah–Sheshi Liria”, Rikonstruksioni i rrugëve “Tasim Këllici”, “Porto Romano” dhe “Bajram Curri”, ku është shpallur fitues OE “Eurondërtimi 2000” shpk, me vlerë më të vogël, më datat 25, 26 dhe dy më datën 27.11.2014, dhe lidhur kontrata, rezultoi se ka paraqitur të njëjtat makineri, staf dhe drejtues teknik në deklaratat përkatëse, të cilët do të punojnë në të njëjtën periudhë kohore prej 2 muaj, në 4 vende të ndryshme. Kryetari i KVO, i cili ka qenë në të 4 procedurat e prokurimit, me vlerësimin e këtij OE ka vepruar në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.07, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”, pika 4, pasi OE me dokumentet e paraqitura nuk mundëson kryerjen e punimeve me dokumentacionin e paraqitur, në të njëjtën kohë. Në tre objekte të tjera të fituara nga OE “Eurondërtimi 2000” shpk, të cilat janë zhvilluar pas procedurës së parë “Bulevardi Dyrrah–Sheshi Liria”, në procesverbalet e mbajtura me përmbajtje të njëjtë për fillimin e punimeve në objekt, nuk janë dhënë emrat e inxhinierëve si dhe nuk janë specifikuar emërtimet e makinerive sipas listës dhe faktit, si dhe është i njëjti drejtues teknik për të tre objektet. Këto objekte nuk kanë shtrirje territoriale apo vendndodhje të njëjtë gjë që përjashton drejtimin nga i njëjti person apo vend ndodhjen gjatë gjithë kohës për çdo objekt të cilat janë me vlerë mbi 30 milion lekë secili në kundërshtim me: Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.5.05, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, dhe UKM nr 3, datë 15.02.01, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, kapitulli I, “Mbi mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit”. 2 nga anëtarët e grupit të mbikëqyrësve për të 10 objektet e kontraktuara për rrugët e lagjes ish Këneta, janë të pa licencuar, në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 7.

Gjithashtu rezultoi se janë zhvilluar Ky OE ka paraqitur të njëjtat makineri, me të njëjtin afat kohor dhe grafik punimesh. Kontratat për këto objekte të prokuruar janë lidhur respektivisht më datat: 10 dhe 11.12.14. Këto kontrata në realizimin e tyre janë me mbivendosje kohore, që kapin të njëjtin hark kohor prej 2 muaj, me të njëjtat makineri, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.07, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”, pika 4, “Hapja dhe vlerësimi i ofertave”, pika “ç”.

17. Rekomandim: Bashkia Durrës dhe strukturat e prokurimit publik KVO të marrin masa të vazhdueshme për zbatimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, në përputhje me kërkesat e LPP dhe akteve ligjore të tij.

Vazhdimisht

18. Gjetje: Komisioni i marrjes në dorëzim për kontratat nr.3590, datë 12.06.14, me vlerë 2.236.265 lekë, me objekt “Blerje gaz për sobë gatimi” dhe nr.5179, datë 03.09.14, me vlerë 34.298.520 lekë me tvsh, me objekt “Blerje Ushqimesh”, të lidhura me subjektin “Start Co” shpk, në procesverbalet mbi marrjen në dorëzim, kanë të njëjtën përmbajtje, ato janë hartuar kopje të njëra tjetrës, duke mos përcaktuar asnjë të dhënë se kujt fature tatimore dhe fletëhyrje i përkasin, vlerën e mallit të ardhur, në kundërshtim me kontratën e lidhura midis palëve, neni 6, me përcaktimin në nenin 4/26, të ligjit 10296, datë 08.07.10 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave (UMF) nr. 30, datë 27.12.11, “Për

menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 36, dhe pikat 42, 44, 45 dhe 46 .

18. Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Durrës të merren masa që grupi i marrjes në dorëzim të mallrave e shërbimeve, të pasqyrojë dokumentacionin shoqërues të tyre dhe të pasqyrojë e argumentojë me shkrim verifikimin faktik të tyre.

Vazhdimisht

19. Gjetje: Bashkia Durrës nuk ka ngritur grupet e marrjes në dorëzim të mallrave nuk ka zbatuar procedurën ligjore për marrjen në dorëzim të punimeve të shërbimit, si dhe të punimeve të ndërtimit pasi, nga ana e Titullarit të AK, nuk është urdhëruar ngritja e grupeve përkatës mosveprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”.

19. Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Durrës të merren masa dhe të urdhërohet ngritja dhe funksionimi i grupeve përkatës të marrjes në dorëzim të mallrave, shërbimeve e ndërtimeve.

Vazhdimisht

20. Gjetje: Gjatë zbatimit të punimeve për ndërtimin e objektit “Rikonstrukcion të Kuartallit Lagja 18 faza e II,” Bashkia Durrës, me kontraktor operatorin ekonomik “Vagalat” sh.p.k. , nuk është siguruar cilësia e punimeve të ndërtimit(për zërin shtresë asfaltbetoni)sipas kërkesave të standardeve, e për pasojë, ka ndodhur dëmtimi i shtresës së asfaltbetonit në sipërfaqen e rrugës prej 10753 m², por pas konstatimit, pasqyrimin të situatës dhe rekomandimit, nga grupi i auditimit të KLSH-së, për eliminimin e problemit, Bashkia Durrës si Autoriteti Kontraktor dhe operatori ekonomik kanë marrë masat përkatëse, duke e kryer përsëri zërin e punimit shtresë asfaltike, duke eliminuar problemin e konstatuar.

20. Rekomandimi: Bashkia Durrësi si Autoritet Kontraktor të marrë masat, për të vlerësuar me përgjegjësi standardet e arritura lidhur me cilësinë e realizimit të zërit të punës shtresë asfaltbetoni për objektin “Rikonstrukcion të Kuartallit Lagja 18 faza e II,” dhe duke qenë se objekti është brenda periudhës së garancisë, për çdo parregullsi të konstatuar të zbatojë penalitetet përkatëse, në përputhje me përcaktimet ligjore.

Menjëherë

21. Gjetje: Në vitin 2013 të ardhurat nga taksat dhe tarifave vendore janë realizuar në shumën 801,837,000 lekë nga 1,104,000,000 lekë të programuara, me diferencë më pak 302,163,000 lekë ose janë realizuar në masën 72.63 %. Në vitin 2014 janë realizuar në shumën 883,038,500lekë, nga 1,260,000,000 lekë të programuara me diferencë më pak 376,696,500 lekë ose janë realizuar në masën 70 %. Peshën më të madhe të mosrealizimit e kanë zënë të ardhurat që lidhen direkt me popullatën (familjarët), si: taksa e pasurisë e cila është realizuar për vitin 2013 në masën 45 % dhe për vitin 2014 në masën 69 %, taksa përkohshme e gjelbërimit e cila është realizuar për vitin 2013 në masën 39% dhe për vitin 2014 në masën 63 %, tarifa e ndriçimit e cila është realizuar për vitin 2013 në masën 26 % dhe për vitin 2014 në masën 48% dhe tarifa e pastrimit dhe largimit mbeturinave e cila është realizuar për vitin 2013 në masën 40 % dhe për vitin 2014 në masën 45%.

21. Rekomandim: Bashkia Durrës, të kërkojë nga OSSHE që të jetë agjenti tatimor për vjeljen e taksave dhe tarifave që kanë lidhje direkt me popullatën si dhe ti kërkojë institucioneve të ndryshme që kanë lidhje direkt me shërbimet ndaj popullatës në rastet e mos pagesave të këtyre taksave të mos u afrohet shërbimi i kërkuar pa paguar taksat dhe tarifat vendore.

Menjëherë

22. Gjetje: Në zbatim të nenit 89, pika 2 të ligjit nr.10 119, datë 23.4.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, të ndryshuar, autoriteti vendor i planifikimit Bashkia Durrës ka iniciuar me vendim nr. 112, datë 10.11.2008, fillimin e hartimit të planit të përgjithshëm rregullues të qytetit të Durrësit, në bazë të projektit për “Administrimin dhe Menaxhimin e Tokës” projekti LAMP mes Bankës Botërore dhe Qeverisë Shqiptare, i cili është miratuar me vendim nr. 123, datë 11.01.2013 të Këshillit të Bashkisë, brenda afatit 2 vjeçar nga data e fillimit të efekteve të plota të këtij ligji.

Instrumenti i Përgjithshëm Vendor (IPV) i Bashkisë Durrës me cilësinë e aktit administrativ që hartohet për të gjithë territorin administrativ të bashkisë, përcakton politikat dhe rregullat e përdorimit të tokës, si dhe strukturën e territorit e drejtimin e infrastrukturës në këtë territor, është miratuar me vendim nr. 27, datë 10.05.2013 nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT).

Ndonëse ky instrument planifikimi është i miratuar, ai nuk është zbardhur pasi paraqet mangësi në rregullore dhe material hartografik në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 481, datë 22.06.2011, të ndryshuar, mangësi këto të evidentuara nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT), e cila me shkresë nr. 170 prot., datë 30.01.2014, kërkon plotësimin e tyre nga Bashkia Durrës si edhe dorëzimin e materialit hartografik në format Autocad dhe ArcGIS.

22.1 Rekomandimi: DPKZHT Bashkia Durrës të plotësojnë mangësitë e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor (IPV) në rregullore dhe material hartografik dhe ky i fundit të shoqërohet me formatet elektronik Autocad dhe ArcGIS.

Deri në datën 30 Nëntor 2015

22.2 Rekomandimi: DPKZHT Bashkia Durrës të bashkëpunojnë konform nenit 9 të ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT) për plotësimin e IPV Bashkia Durrës, përputhjen e tij me instrumentet kombëtare të planifikimit, të miratuara ose në proces si dhe zbardhjen e këtij instrumenti.

Menjëherë

23. Gjetje: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (DPKZHT), Bashkia Durrës gjatë vitit 2013 ka shqyrtuar 8 leje zhvillimore ndërtimi, të cilat janë miratuar nga Kryetari i Bashkisë. Në kushtet e mungesës së zbardhjes së Instrumentit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Durrës, vendimmarrja për këto leje është bërë duke u bazuar në vendimin Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë (KRRTRSH) Nr. 08, datë 15.03.2005 "Për miratimin e studimit për ndryshimin e kondicioneve urbane të zonës së plazhit Durrës", si dhe rregullave, normave dhe kushteve të zhvillimit të këtij studimi. Kjo pasi konform nenit nr. 47 të VKM nr. 502, datë 13.07.2011, të ndryshuar, pika 1. Vendimet e miratuara nga KRRTRSH-ja, para fillimit me efekte të plota të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për Planifikimin e Territorit", të ndryshuar, mbeten në fuqi.

Në lidhje me auditimin me zgjedhje të dokumentacionit të dosjeve të subjekteve që kanë marrë leje zhvillimore, në zbatim të procedurave, nga 8 praktika të zbardhura u vlerësuan dhe përzgjedhën për auditim 4 praktika në të cilat rezultuan mangësi në dokumentacion si dhe mos publikim të akteve të lejeve në Regjistrin e Planifikimit të Territorit, në kundërshtim me nenin 53 të ligjit nr. 10 119 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, për rastet e pasqyruara në Aneksin 1, Tabela 01.

23.1 Rekomandimi: Të publikohen aktet e lejeve zhvillimore të ndërtimit në Regjistrin e Planifikimit të Territorit konform nenit 56 të ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", për praktikën e pasqyruara në Aneksin 1, tabela 01.

Menjëherë

23.2 Rekomandimi: Përpara miratimit të Certifikatës së Përdorimit konform nenit 42 të ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", ti kërkohet subjekteve zhvilluese të plotësojnë mangësitë në dokumentacionin e lejeve të zhvillimit për objektet me leje zhvillimore ndërtimi pasqyruar në Aneksin 1, Tabela 01.

Menjëherë

24. Gjetje: Për vitin 2014, në zbatim të VKM nr. 199, datë 02.04.2014 dhe Udhëzimit nr. 4, datë 14.04.2014 të Ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, DPKZHT Bashkia Durrës ka miratuar 3 leje zhvillimore ndërtimi pas konfirmimit nga AKPT në lidhje me kërkesat e kontrollit të përputhshmërisë me instrumentet kombëtare dhe/ose vendore të planifikimit, të miratuara ose në proces për të gjitha zhvillimet që kërkojnë të kryhen, përfshirë edhe zonat e pezulluara me vendim të KKT.

Për sa i përket auditimit me zgjedhje të dokumentacionit të dosjeve të subjekteve që kanë marrë leje zhvillimore ndërtimi gjatë vitit 2014, në zbatim të procedurave, nga 3 praktika të zbardhura u vlerësua dhe u përzgjedh për auditim 1 nga këto praktika e vlerësuar me risk më të lartë.

1. Leje zhvillimore ndërtimi nr. 5072 prot., datë 27.08.2014, miratuar me vendim nr. 16, datë 27.08.2014 të Kryetarit të Bashkisë Durrës, bazuar në raportin tekniko-ligjor të Drejtorisë së Planifikimit të Bashkisë Durrës, për “Shtesë në objektin ekzistues kombinat i prodhimit të konfeksioneve” L. 15 Rr. Aleksandër Goga Durrës, me pronarë shoqëria “A...” s.r.l dhe zbatues shoqëria “D...”. Akti i lejes nuk është publikuar në Regjistrin e Planifikimit të Territorit, në kundërshtim me nenin 53 të ligjit nr. 10 119 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar.

24.1 Rekomandimi: Të publikohet akti i lejes zhvillimore të ndërtimit nr. 5072 prot., datë 27.08.2014, miratuar me vendim nr. 16, datë 27.08.2014 të Kryetarit të Bashkisë Durrës, për “Shtesë në objektin ekzistues kombinat i prodhimit të konfeksioneve” L. 15 Rr. Aleksandër Goga Durrës, me pronarë shoqëria “A....” s.r.l dhe zbatues shoqëria “D....” në Regjistrin e Planifikimit të Territorit konform nenit 56 të ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit".

Menjëherë

25. Gjetje: Të gjitha praktikatat e lejeve të audituara nuk rezultojnë të jenë të inventarizuara dhe numerizuara konform ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

25.1 Rekomandimi: Nga Arkiva e Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit Bashkia Durrës të merren masa për inventarizimin dhe numerizimin konform ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, për të gjitha praktikatat e lejeve të audituara.

Menjëherë

26. Gjetje: Me VKM nr. 536, datë 01.05.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim Bashkisë Durrës”, ka përfunduar procesi i transferimit të pronave. Kështu, janë transferuar 1159 prona gjithsej, 938 në pronësi dhe 221 në përdorim.

-Për të gjithë pronat e transferuara nuk është bërë regjistrimi paraprak në kontabilitetin e Bashkisë.
- Janë në proces të mbledhjes të të dhënave dhe të plotësimit me dokumentacionin e nevojshëm të 39 pronave të transferuara nga sistemi i bujqësisë dhe ushqimit. Deri në momentin e auditimit akoma nuk është bërë e mundur dorëzimi i tyre.

- Janë kaluar në pronësi 472 vendstrehime të sistemit të Mbrojtjes. Këto prona nuk kanë numër pasurie dhe indeks harte, si pasojë nuk është pranuar aplikimi. Deri në momentin e auditimit, nuk janë plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm, dhe nuk është bërë e mundur dorëzimi i tyre

- Janë transferuar 189 prona të cilat janë rrugë dhe rrugica. Për regjistrimin e tyre janë hasur pengesa sepse ka një mospërputhje të të dhënave teknike me gjendjen në fakt dhe me gjendjen në kontabilitetin e ndërmarrjes që i ka pasur në inventar. Deri në momentin e auditimit akoma nuk është bërë e mundur marrja e certifikatave të pronësisë.

- Këshilli Bashkiak ka marrë disa vendimi për shtesë në listën e pronave të fushave të ndryshme të cilat nuk janë përfshirë në listën përfundimtare. Deri në momentin e auditimit nuk është bërë e mundur transferimi i tyre.

- Janë transferuar në pronësi të Bashkisë, 62 prona në inventar të institucioneve të tjera, por deri në momentin e auditimit këto prona akoma nuk janë dorëzuar dhe plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm.

- Deri në momentin e auditimit ende nuk është bërë plotësimi me dokumentacionin e nevojshëm të disa pronave të cilat për arsye subjektive nuk janë përfshirë në listën përfundimtare të miratuar me VKM e sipërcituar.

26.1 Rekomandim: Të ngrihen grupe pune për të plotësuar me dokumentacionin e mjaftueshëm pronat e transferuara nga institucionet që i kanë pasur në inventar ato me qëllim vlerësimin paraprak dhe regjistrimet në kontabilitet, në përputhje me pikën 22 të VKM-së nr. 500, datë

14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”.

Menjëherë

26.2 Rekomandim: T’i kërkohet Ministrisë së Bujqësisë, që pronat e këtij sistemi të kaluara në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë të plotësohen me dokumentacionin e nevojshëm për të bërë dorëzimin dhe regjistrimin e tyre në ZVPPP.

Menjëherë

26.3 Rekomandim: T’i kërkohet Ministrisë së Mbrojtjes që 472 vendstrehimet të kaluara në pronësi të Bashkisë të plotësohen me numër pasurie dhe indeks harte për të bërë regjistrimin e tyre në ZVPPP.

Menjëherë

26.4. Rekomandim: T’i kërkohet Ministrisë së Drejtësisë që të ndërhyjë në ZRPP për të bërë azhurnimin e sipërfaqeve të 189 pronave (rrugë dhe rrugica) me regjistrat hipotekar për të mundësuar marrjen e certifikatave të pronësisë.

Menjëherë

26.5 Rekomandim: Të ngrihen grupe pune të përbashkëta me institucionet përkatëse që kanë pasur në inventar 62 pronat të cilat janë transferuar Bashkisë, për të bërë plotësimin me dokumentacionin e nevojshëm, azhurnimin me terren dhe më pas dorëzimin e tyre.

Menjëherë

26.6 Rekomandim: Të ngrihet grup pune për plotësimin me dokumentacionin e nevojshëm të pronave të evidentuara nga Bashkia të cilat nuk janë përfshirë në listën përfundimtare të miratuar, dhe t’i kërkohet AITPP-ja transferimi dhe përcjellja për miratimi në KM-ve.

Menjëherë

27. Gjetje: Bashkia Durrës, në vitin 2013 ka pasur 62 kontratat qiraje të lidhura dhe në vitin 2014 ka pasur 52 kontratat qiraje të lidhura. Në lidhje me administrimin dhe monitorimin e zbatimit të kontratave të qirave u evidentuan dy problematika që i përkasin: ndërmarrjes së parkut urban e cila nuk ka futur në kontabilitet dhe nuk ka marrë në posedim pronën e emërtuar “biletari” dhe Qendrës Ekonomike të Arsimit e cila nuk ka marrë në posedim “bazën prodhuese të arsimit”. Këto objekte ishin dhënë me qira dhe për shkak të mos shlyerjes në kohë të detyrimeve, qiramarrësve u janë ndërprerë kontratat dhe duhet të lironin këto objekte.

27.1 Rekomandim: Të bashkëpunohet me Policinë e Shtetit për të bërë të mundur lirimin e objektit “biletari” dhe objektit “baza prodhuese e arsimit”.

Menjëherë

28. Gjetje: Në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit” të ndryshuar dhe VKM nr. 862, datë 5.12.2007, të ndryshuar, për rastet e ekzekutimit të vendimit për prishje, në asnjë rast nuk është marrë vendim zhdëmtimi në ngarkim të subjektit kundërvajtës, për shpenzimet e prishjes së objektit dhe të kthimit të truallit në gjendjen e mëparshme.

28.1 Rekomandimi: Për të gjithë rastet e ekzekutimit të vendimit për prishje të objektit të kundraligjshëm të merren vendime zhdëmtimi në ngarkim të subjektit kundërvajtës për shpenzimet e prishjes së ndërtimit dhe të kthimit të truallit në gjendjen e mëparshme, konform nenit 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit” të ndryshuar me ligj nr. 183/2014 “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për Inspektimin e Ndërtimit”, të ndryshuar.

Vazhdimisht

29. Gjetje: IMKTV Bashkia Durrës në asnjë rast nuk ka paraqitur pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimeve pa leje, si dhe në rastet e shkeljeve të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të punimeve të ndërtimit, në kundërshtim me specifikimet e nenit 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit” të ndryshuar.

29.1 Rekomandimi: Për të gjithë rastet e ndërtimeve të kundërligjshme të paraqitet pranë organeve përkatëse kërkesa për heqje të licencës profesionale, personale ose të shoqërisë, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të ndërtimit, konform nenit 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit” të ndryshuar me ligj nr. 183/2014 “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për Inspektimin e Ndërtimit”, të ndryshuar.

Vazhdimisht

30. Gjetje: Policia Bashkisë Durrës, gjatë viteve 2013-2014 ka performancë të pamjaftueshme të punës shprehur me mungesën dhe kufizimin (vetëm tek tregtarët ambulant) e veprimtarisë në kontrollin tërësor të territorit në evidentimin e nxjerrjen e përgjegjësive, marrjen e masave ndaj subjekteve debitor për taksat, subjekteve mbi trajtimin e mjedisit e të infrastrukturës mungesën e bashkëpunimit me strukturat e tjera si INUV, Njësia e Mjedisit, Urbanistikë, Drejtorinë e tatime Taksave etj, gjë që tregohet nga struktura e gjobave ndaj subjekteve; dhe pamjaftueshmëri shprehur me nivelin e ulët të gjobave të vendosura 1/gjobë/muaj për punonjës policie, si dhe me mungesën e rakordimit me Financën me pasojë derdhjet të vonuara të gjobave në bankë rrjedhur nga mungesa e vendosjes së mekanizmave të kontrollit të brendshëm lidhur me administrimin, rakordimin, kontrollin e blloqeve të Fletë Gjobave, inventarizimin derdhjen në kohë të vlerave monetare, mosveprime në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, paraqitur në tabelat “Emërtimi dhe Struktura e Gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake sipas drejtimeve apo subjekteve për vitet 2013 dhe 2014”, “Gjobat e vendosura dhe derdhjet e vonuara nga punonjësit e policisë sipas viteve nga vitet 2011, derdhur në vitet 2013, 2014 dhe 2015”.

30.1 Rekomandim: Bashkia Durrës Drejtoria Ekonomike dhe Policia Bashkiake të marrin masa të kryejnë rakordimin e blloqeve të fletë gjobave dhe të kërkojnë arkëtimin e vlerës së gjobave të prera dhe të vonuara e pa derdhura në Bankë që i përkasin vitit 2013-2014 sipas pasqyrës “Gjobat e vendosura dhe derdhjet e vonuara nga punonjësit e policisë sipas viteve nga vitet 2011 derdhur në vitet 2013, 2014 dhe 2015”.

Menjëherë

30.2 Rekomandim: Bashkia Durrës dhe Policia bashkiake të hartojë planveprime mujore ku të përfshijë bashkëpunimin me strukturat e tjera si INUV, Njësia e Mjedisit, Urbanistikë, Drejtorinë e tatime Taksave etj, me synim vënien nën kontroll tërësor të territorit ruajtjen nga zaptimi e përdorimi i paligjshëm i Pronave dhe aseteve publike të Bashkisë, kontrollin e veprimtarive për rritjen e shkallës së edukimit e ndërgjegjësimit të publikut në mirë përdorimin e territorit ruajtjen e mjedisit, rendit social etj, si dhe rritjen e performancës së punës së Policisë.

Vazhdimisht

30.3 Rekomandim: Bashkia Durrës Drejtoria Ekonomike dhe Policia Bashkiake të marrin masa dhe të vendosin sistemin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm, afatin e mbylljes së veprimeve dhe rakordimet përkatëse punonjës Policie me Sektorin e financës inventarizuesen e Letrave me vlerë, si dhe në Rregulloren e Brendshme të Seksionit të Policisë Bashkiake, Kreun e III “Dokumentacioni që mbahet në Seksionin e Policisë Bashkiake, neni 7, pika ku shprehet për “Regjistrin e Gjobave të vendosura nga efektivit i Policisë Bashkiake”, të përfshihet e shprehet për mekanizmat dhe procedurat që duhen ndjekur, për kohën mënyrën dhe afatet e likuidimit dhe për mënyrën e rakordimit të blloqeve të gjobave të marra në dorëzim, blloqet dhe fletë gjobat e prera, të likuiduara dhe të ato mbetura në bllok apo të pa përdorura.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore“, i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, pjesa e VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit

publik” Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe (Nëpunësi zbatues), të kryejë kontabilizimet duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe procedurat përmbarimore me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën si më poshtë:

1. Gjetje: Drejtoria e Auditimit të Brendshëmka kryer auditime gjatë viteve 2013 dhe 2014, në Ndërmarrjet e Varësisë së bashkisë si: Ndërmarrja e Parkut Urban Durrës, Ndërmarrja e Parkut Eksportit Durrës, dhe Ndërmarrja e Tregtisë me Shumicë Durrës, mbi të cilat Bashkia Durrës dhe Nd/jet përkatëse, nuk kanë ushtruar të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, pra nuk ka vënë nën administrim asetet e llojit ndërtesa e troje. Nga auditimet e kryera nuk janë trajtuar në thellësinë e duhur marrja nën administrim, identifikimi dhe vënia në efikasitet, kontratat e qirave, zaptimi dhe përdorimi i kundraligjshëm nga persona të tretë duke mos dhënë rekomandimet e duhura, mosllogaritur e kërkuar dëmin ekonomik dhe të ardhurat e munguara në vlerën totale prej **13,725,000 lekë**, si nivel qeraje i munguar nga përdorimi e zaptimi i paligjshëm për periudhën 3 vjeçare, auditime me moszbatim e shkelje të procedurave të auditimit në kundërshtim me ligjin nr. 9720, datë 24.4.2007”Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”,ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010 ”Për disa shtesa e ndryshime të ligjit nr. 9720”dhe me VKM nr. 345, datë 01.06.2004 “Manuali i Procedurave të Auditimit”, mbajnë përgjegjësi Drejtoria e Auditimit të Brendshëm dhe konkretisht pasoja e dëmi ekonomik dhe të ardhurat e munguara pasqyruar në tabelën “Dëmi ekonomik nga zaptimi i Ndërtesave e trojeve për 3 Nd/je Bashkia Durrës”, si poshtë:

Dëmi ekonomik nga zaptimi i Ndërtesave e trojeve për 3 Nd/je Bashkia Durrës

Emërtimi i objektit, pronësia dhe vendndodhja	Sip m ²	Tarifa e qirasë sipas VKM 529, ndrysh 54 lek/m /muaj			Vlera e qirasë 000/lekë vjetore			Demi dhe Ardh mung u ara 000/le k
		Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	
1 .Biletari e Ndje Transp Urban pranë Stacionit trenit Durrës	20,5	150	150	200	36,9	36,9	49,2	123
2. Nd/je parkut Eksportit Durrës	2591				3877,8	3877, 8	4646, 4	12402
Ndërtesë	1281	150	150	200	2305,8	2305, 8	3074, 4	7686
Truall	1310	100	100	100	1572	1572	1572	4716
3. Ndërtese 2KT pronë e Ndje Tregtisë me Shumicë Durrës, zaptuar nga I.J.	200	150	150	200	360	360	480	1200
TOTAL ZAPTIMI	2811, 5				4274,7	4274, 7	5175, 6	13725
Ndërtesa	1501, 5				2702,7	2702, 7	3603, 6	9009
Truall	1310	100	100	100	1572	1572	1572	4716

1.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës dhe Nd/jet Parku Urban, nd/je Tregtare me Shumicë, Nd/je Parkut Eksportit dhe DAB të ushtrjnë të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore pra të marrin e vënë nën administrim,të denoncojnë e kërkojnë identifikimin e personave pranë organeve të Policisë, lirimin e objekteve që përdoren nga zaptimi pa titull pronësie të aseteve të llojit Ndërtese 1501,5 m² dhe 1310 m² trualli, si dhe të kërkojë ndaj personave arkëtimin e

dëmit ekonomik dhe të ardhurat e munguara në vlerën **13,725,000 lekë** për periudhën 3 vjeçare (dhe më tej prej fillimit), që përdoren nga zaptimi pa titull pronësie, fakte këto që megjithëse janë njohur por nuk janë formuluar e rekomanduar masat, nga audituesit e DAB, pasqyruar në tabelën “Dëmi ekonomik nga zaptimi i Ndërtesave e trojeve për 3 Nd/je Bashkia Durrës”.

Menjëherë

2. Gjetje: Bashkia Durrës ka detyrime nga vendimet gjyqësore të mbajtura jashtë kontabilitetit duke mos çelur llogaritë përkatëse të kreditorëve, të rrjedhura kryesisht nga ndërprerjet e marrëdhënieve të punës para vitit 2013, në vlerë 5,701,253 lekë, ndaj 5 nëpunësve. Gjithashtu në vitin 2014, detyrimet janë shtuar nga moszbatimi i kthimit në punë edhe për 2 kreditorë të tjerë nëpunësit dhe detyrimi total arrin në shumën **8,490,972 lekë**, që ka sjellë si pasojë shkeljen e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008”Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor” dhe ligjit nr.10296 ”Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 5.

2.1 Rekomandim: Bashkia Durrës, të analizojë e nxjerrë përgjegjësinë për mos administrimin, sistemimin dhe evidentimin në evidencën kontabile dhe mos menaxhimin në Buxhet të detyrimeve kreditorë, me pasojë rëndimin e buxhetit dhe destinacioneve, si dhe të marrë masa për çeljen e pasqyrimin në llogarinë “Kreditorë” dhe për shlyerjen e menjëhershme të detyrimit kreditor prej vendimeve të gjykatave në vlerën prej **8.490.972 lekë**, me synim frenimin e rritjes së vlerës nga mosshlyerja në kohë.

Deri në datë 30 Nëntor 2015

3 Gjetje: Bashkia Durrës, sektori i financës nuk ka zbatuar vullnetarisht vendimin e Gjykatës të Durrës, nr. 123, datë 02.02.98, në favor kreditorit Filip Rroço, dhe nuk ka çelur llogarinë përkatëse kreditorë të detyrimit për shumën 3.056.544 lekë, dhe të detyrimit shtesë në shumën **2,113,320 lekë**, rrjedhur nga moszbatimi Vendimit Gjykatës nr. 1650, datë 04.06.2009, dhe shkresës nr. 49, datë 24.12.2012, të Zyrës Përmbarimore Durrës, pra detyrimi total në vlerën **5,169,864 lekë** përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë me ndikim në rritjen e shpenzimeve të artikullit 602, “Shpenzime operative”, veprime dhe mosveprime këto në kundërshtim me nenin 5, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiarë e kontrollin” dhe me ligjin nr. 9228, datë 29.5.2004”Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

3.1 Rekomandim: Bashkia Durrës, të analizojë e nxjerrë përgjegjësinë për mos administrimin, sistemimin dhe evidentimin në evidencën kontabile dhe për mos menaxhimin në Buxhet të detyrimeve kreditorë, me pasojë rëndimin e destinacioneve të buxhetit dhe si dhe të marrë masa për çeljen e llogarisë kreditorë dhe shlyerjen e menjëhershme të detyrimit kreditor prej vendimeve të gjykatave në vlerën prej vlerën **5,169,864 lekë**, ndaj kreditorit Filip Rroço përcaktuar sipas vendimeve të gjykatës nr. 123, datë 02.02.98, dhe nr. 1650, datë 04.06.2009, me synim frenimin e rritjes së vlerës nga mosshlyerja në kohë.

Deri në datë 30 Nëntor 2015

4. Gjetje: Në 8 raste, nga 29 praktika të audituara të lejeve të përdorimit, të paraqitura në Aneksin 1, Tabela 03, është konstatuar se subjektet ndërtuese kanë shkelur afatin e lejes së ndërtimit. Duke qenë se lejet e ndërtimit për këto raste janë miratuar konform ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998“Për Urbanistikën”, të ndryshuar, VKM nr. 502, datë 13.07.2011, e ndryshuar, neni 47 parashikon se për to procedohet konform kushteve të përcaktuara në leje. Sipas nenit 57 dhe 81 të ligji nr. 8405, datë 17.09.1998“Për Urbanistikën”, të ndryshuar, për shkeljen e afatit të lejes së ndërtimit subjektet gjobiten me vlerë 50,000 – 200,000 lekë.

Nga mos vendosja e mos arkëtimi i këtyre gjobave janë shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e njësisë vendore në vlerën 1,150,000 lekë .

4.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës, me strukturat përkatëse, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV), të analizojnë performancën e pamjaftueshme të punës dhe të marrin masa, kontabilizojnë dhe kërkojnë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **1,150,000 lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit,

shkaktuar si rezultat i shkeljes së afatit të lejes së ndërtimit për praktikat e paraqitura në Aneksin 1, Tabela 03.

Menjëherë

5. Gjetje: Në procedurën e prokurimit me objekt “Projekt Zbatim për Promenadën Bregdetare dhe Plazhin publik nga bërri deri në Currila” me fond limit 17,500,000 lekë, tarifa e projektimit (fondi limit) është llogaritur sipas përcaktimeve të VKM nr 444, datë 05.09.1994 “për tarifat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të veprave të nderimit” dhe bazuar në vlerat e kontratave të ngjashme për punët të kryera nga vetë Bashkia në periudha të mëparshme. Mirëpo, tarifa e llogaritur në përputhje me këtë VKM, del në vlerën 2,669,599.8 lekë, ndërsa Autoriteti Kontraktor në kundërshtim me këtë VKM e ka llogaritur, në vlerën 21,000,000 lekë me, diferencë me tepër në vlerën 18,330,400 lekë. Po kështu edhe tarifa e projektimit sipas ofertës ekonomike të shoqërisë fituese të këtij tenderi “S....A” është paraqitur në vlerën 20,988,000 lekë, pra pothuajse sa fondi limit ose me diferencë të papërfillshme në vlerën 12,000 leke. Me shoqërinë fituese është lidhur kontrata për hartimin e projektit të zbatimit dhe preventivit të zbatimit me vlerë 20,988,000 lekë. Si pasojë e këtij veprimi në kundërshtim me, VKM e sipërcituar shoqëria projektuese “S.....A” ka përfutuar padrejtësisht duke i shkaktuar dëm ekonomik Buxhetit të Bashkisë në vlerën 18,318,400.2 lekë.

5.1 Rekomandim: Të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar shoqëria projektuese “S.....A” shpërblimin e dëmit në vlerën 18,318,400.2 lekë.

Menjëherë

6. Gjetje: Bashkia Durrës ka kryer pagesa të tepërta për punime e volume punë të pakryera për 7 objekte ndërtimor në vlerën e dëmit ekonomik prej **5,522,245 lekë**, si më poshtë:

6.1 Gjetje: Bashkia Durrës si Autoriteti Kontraktor ka kryer pagesa të tepërta në vlerën **98,000 lekë** ndaj bashkimit të operatorëve ekonomik “R....Ndërtim” sh.p.k. dhe “C...” sh.p.k., në situacionimin e volumeve të punimeve për 2 zëra punimesh me diferenca volumesh të pa kryera, në objektin “Rikonstruksion të Kuartallit Lagja 17, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 412, datë 10.09.2013.

6.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës si Autoriteti Kontraktor, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **98,000 lekë**, nga bashkimi i operatorëve ekonomik “R.... Ndërtim” sh.p.k. dhe “C.....” sh.p.k., paguar për situacionimin e volumeve të punimeve të pa kryera në objektin “Rikonstruksion të Kuartallit Lagja 17.

Menjëherë

6.2 Gjetje: Bashkia Durrës si Autoriteti Kontraktor ka kryer pagesa të tepërta në vlerën **484,330 lekë**, ndaj operatorit ekonomik “V....” sh.p.k., në situacionimin e volumeve të punimeve për 7 zëra punimesh me diferenca volumesh të pa kryera, për ndërtimin e objektit “Rikonstruksion të Kuartallit Lagja 18 faza e II”, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 155, datë 11.01.2013.

6.3 Rekomandimi: Bashkia Durrës si Autoriteti Kontraktor të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **484,330 lekë**, nga operatori ekonomik “V....” sh.p.k., paguar për situacionimin e volumeve të punimeve të pa kryera në objektin “Rikonstruksion të Kuartallit Lagja 18, faza e II”.

Menjëherë

6.4 Gjetje: Bashkia Durrës si Autoriteti Kontraktor ka kryer pagesa të tepërta në vlerën **75,200 lekë** ndaj bashkimit të operatorëve ekonomik “R....” sh.p.k. dhe “V...” sh.p.k., në situacionimin e volumeve të punimeve për 5 zëra punimesh me diferenca volumesh të pa kryera, për ndërtimin e objektit “Rikonstruksion i Rrugës “Vath Truja”, Lagja Shkozë”, Bashkia Durrës, në kundërshtim me kushtet e kontratës nr. 3300, datë 03.04.2014.

Menjëherë

6.4.1 Rekomandimi: Bashkia Durrës si Autoriteti Kontraktor të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **75,200 lekë**, nga bashkimi i operatorëve ekonomik “R..” sh.p.k. dhe “V sh.p.k.,

paguar për situacionimin e volumeve të punimeve të pa kryera në objektin “Rikonstruksion i Rugës “Vath Truja”, Lagja Shkozet”.

Menjëherë

B/1. MASA PËR MOS PËRDORIMIN ME EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE DHE RESURSEVE TË NJËSISË PUBLIKE:

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit në tenderat e zhvilluar, u konstatuan se në 3 raste me vlerë kontrate 87,208,600 lekë me tvsh, ka mos përmbushje të rregullave të caktuara në procedurat e prokurimit, mos përdorim me efektivitet, efencë dhe ekonomicitet të fondeve publike të vëna në dispozicion, si dhe përdorimin me diferencë negative në fondet buxhetore në vlerën totale **21,873,606 lekë pa TVSH**. Vlerë kjo që përcaktohet në objektet: “*Rikonstruksion i segmentit të bulevardit Dyrrah- Sheshi Iliria, objekti “ Rikualifikim fasadash dhe Blerje mllrash (gaz për sobë gatimi)*”, veprime në kundërshtim me nenin 1, 2 dhe 24, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe kreu V, pika 1/a dhe pika 4/h, të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar

1.1. Rekomandimi: Bashkia Durrës të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, ekonomicitet dhe efencë të fondeve publike, për 3 procedurat e prokurimeve me efekte negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën **21,873,606 lekë pa TVSH**, duke vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike në shërbim të komunitetit.

Brenda muajt Shtator 2015

2. Gjetje: Në 77 raste vendimesh të pa ekzekutuara për prishje punimesh pa leje me dhe pa pasojë krijimin e shtesave në sipërfaqe e vëllim ndërtimor,(sipas Tabelave 01 dhe 02 të Aneksit 02), nga pamjaftueshmëria e punës dhe performancës së dobët të strukturave IVMT e Bashkisë Durrës dhe bashkëpunimi me IUKMT Tiranë,nuk janë vendosur gjobat përkatëse sipas rastit, në kundërshtim me VKM nr. 862, datë 5.12.2007, të ndryshuar, pika 8, me nenin 47 të ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” me nenin 82, pika 8, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, të ndryshuar dhe me nenit 52, pika 1 e), të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”.

Në total, vlera e të ardhurave të munguara shkaktuar buxhetit të njësisë vendore nga një performancë e pamjaftueshme kësaj njësievendore, lidhur me mosvendosjen dhe mos arkëtimin e gjobave lidhur me kontrollin e territorit të Bashkisë, e cila është në vlerën 10,100,000 lekë .

33 Rekomandimi: Bashkia Durrës të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos efektivitetin, ekonomicitetin dhe efencën e IVMT së Bashkisë, duke analizuar pamjaftueshmërinë dhe performancën jo të mirë të punës së IVMT, me pasojë krijimin e të ardhurave të munguara në shumën 10,100,000 lekë. Pas analizë dhe nxjerrjes së rezultateve, të marrë masat për të ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për rivendosjen e gjobave dhe arkëtimin e tyre, për kryerje të punimeve pa leje .

Brenda muajit Shtator 2015

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 58, germa a, b, c, ç, “*Llojet e masave disiplinore*”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”,në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, si dhe nenit 8, të kontratave individuale të punës, në nenin 44, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, i kemi kërkuar Kryetarit të Bashkisë Durrës, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga puna**” dhe për ata me kontratë, nga masa “**Vërejtje**” deri në “**Ndërrprerje të marrëdhënieve të punës**”, për këta punonjës:

1. z. K.T, e cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurat e prokurimit: “Blerje kancelari dhe tonera për Bashkinë”, me fond limit 3,199,275 lekë, “Rikonstruksion i Kopshtit 1 Qershori” me fond limit 6,101,000 lekë dhe “Rikonstruksion rruge në Plazh Milto Kulja, segment rruga Qafebot dhe vazhdimi deri tek rruga “Pavarësia” me fond limit 31,844,000 lekë, të realizuara në vitin 2013, ka s`kualifikuar nga këto procedura disa operatorë ekonomik në kundërshtim, me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe me VKM-në nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2. znj. A.K, me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurën e prokurimit: “Blerje kancelari dhe tonera për Bashkinë”, me fond limit 3,199,275 lekë, të realizuar në vitin 2013, ka s`kualifikuar nga kjo procedurë operatore ekonomik në kundërshtim, me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe, me piken . të Kreut IV të VKM-në nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat Prokurimit Publik” i ndryshuar,

Në tenderin e zhvilluar me objekt: **“Blerje Gaz për sobë gatimi”**, me fond limit 2.553.600 lekë, nisur nga gjetjet e konstatuara të dy OE nuk i plotësojnë kriteret e kualifikimit dhe ky tender duhej të anulohet. Efekti ekonomik negativ i procedurës është oferta e “S...”shpk me marzh fitimi 19 lek/kg dhe me vlere 1.967.465 leke pa tvsh - oferta e “S.... Co”shpk me marzh fitimi 35 lek/kg dhe me vlere 2.236.265 leke = **268.800 lekë**.

3. z. Zh.V, me detyrë Zv. Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave për procedurat e prokurimit:

“Rikonstruksion i Kopshtit 1 Qershori” me fond limit 6,101,000 lekë dhe “Rikonstruksion i rrugëve “Parthineve dhe Shqipeve” me fond limit 23,092,897 lekë, të realizuara në vitin 2013, ka s`kualifikuar nga këto procedura disa operatore ekonomik në kundërshtim, me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe, me VKM-në nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat Prokurimit Publik” i ndryshuar.

- **“Rikonstruksion i segmentit “Bulevardi Dyrrah – Sheshi Liria”**, Fondi limit 56.328.000 lekë, oferta e OE “E.... 2000”shpk & “E...”shpk nuk është e vlefshme dhe KVO, duhej të anulonte tenderin, pasi asnjë nga OE nuk ka paraqitur dokumentacion sipas kërkesave të DT. **Efekti ekonomik negativ** nga zhvillimi i kësaj procedure është 14.505.444 lekë (diferenca midis OE me vlerë më të ulët “A.-Impex” shpk & “G..Construction”shpk & “N..” shpk 37.440.471 lekë-ofertën e BOE “E... 2000” shpk & “E...”shpk 51.945.915 lekë.

-**“Rikualifikim Fasdash”**, me fond limit **28.327.000** lekë. Për mosanulimin e procedurës së prokurimit, dhe për kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “B...” shpk, pasi nga audtimi rezultoi se të gjithë OE nuk plotësojnë kriterete e vecanta e të përgjithshme për kualifikim me **efekt ekonomik negativ 7.099.402 lekë**.

- **“Blerje Gaz për sobë gatimi”**, me fond limit 2.553.600 lekë Për mosanulimin e procedurës së prokurimit, dhe për kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “S.... CO”shpk, me efekti ekonomik negativ të procedurës **268.800 lekë**.

- **për kualifikimin dhe shpalljen fitues** të OE, ‘Eurondërtimi 2000” shpk në tre procedurat Rikonstruksion i rruges “Tasim Kellici”, Rikonstruksion i rruges “Porto Romano”, Rikonstruksion rruge “Bajram Curri” të zhvilluara në të njëjtën me të njëjtat mjete e staf për realizimin e objektit të prokuruar e të kontraktuar.

- **për kualifikimin dhe shpalljen fitues** të BOE, “Ç...”shpk & “V...”shpk, në objektet “Rikonstruksion rruge “Polumbari” dhe “Rikonstruksion rruge “Durrësi në shekuj” të zhvilluara në të njëjtën datë, orë të ndryshme, në të cilat KVO, ka klasifikuar dhe më vonë janë lidhur kontrata me të njëjtin BOE, “Ç....”shpk & “V...”shpk, i cili ka paraqitur të njëjtat makineri për kryerjen e punimeve, në dy objekte të ndryshme, me të njëjtin afat kohor, grafik punimesh., duke moszbatuar VKM nr. 1, datë 10.01.07, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”, pika 4, “Hapja dhe vlerësimi i ofertave”, pika “ç”.

4. znj. E.Isa Kalesha, me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e prokurimit: “Rikonstruksion i Kopshtit 1 Qershori”, me fond limit 6,101,000 lekë, të realizuara në vitin 2013, ka s`kualifikuar nga kjo procedurë operatorë ekonomik në kundërshtim, me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe, me VKM-në nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat Prokurimit Publik” i ndryshuar.

5. znj. D.D, me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurën e prokurimit: “Rikonstruksion rruge ne Plazh Milto Kulja segment rruga Qafebot dhe vazhdimi deri tek rruga “Pavarësia”, me fond limit 31,844,000 lekë, të realizuar në vitin 2013, ka s`kualifikuar nga kjo procedurë operatorë ekonomik në kundërshtim, me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe, me VKM-së nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat Prokurimit Publik” i ndryshuar. Po kështu me cilësinë Anëtarët të Komisionit të Llogaritjes së Fondit Limit të procedurës së prokurimit “Projekt Zbatim për Promenadën Bregdetare dhe Plazhin publik nga bërryli deri në Currila”, me fond limit 17,500,000 lekë, të realizuar në vitin 2013, ka llogaritur tarifën e projektimit (fondin limit) më tepër në vlerën 18,330,400 lekë, në kundërshtim me VKM nr 444, datë 05.09.1994 “Për tarifat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit te veprave te nderimit”.

Dhe në cilësinë e anëtares së të Grupet të hartimit të specifikimeve teknike dhe përlllogaritjes së fondit limit per vitin 2013-2014, për shkeljet e cilësuar për personat sipas nr.19 .

6. z. V.M, ky punonjës, i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “NIKA” për procedurën e prokurimit: “Rikonstruksion rruge në Plazh Milto Kulja segment rruga Qafebot dhe vazhdimi deri tek rruga “Pavarësia” me fond limit 31,844,000 lekë, të realizuar në vitin 2013, nuk ka argumentuar teknikisht dhe ligjërisht arsyet e s`kualifikimit të këtij operatori ekonomik ankues, në kundërshtim, me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe me VKM-së nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat Prokurimit Publik” i ndryshuar.

7. z. I.S, me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurë e prokurimit: “Rikonstruksion i rrugëve “Parthineve dhe Shqipeve”, me fond limit 23,092,897 lekë, të realizuar në vitin 2013, ka s`kualifikuar nga kjo procedurë operatorë ekonomik në kundërshtim, me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe me VKM-në nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat Prokurimit Publik” i ndryshuar.

8. z. D.B, me cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurë e prokurimit: “Rikonstruksion i rrugëve “Parthineve dhe Shqipeve” me fond limit 23,092,897 lekë, të realizuar në vitin 2013, ka s`kualifikuar nga kjo procedurë operatorë ekonomik në kundërshtim, me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe me VKM-në nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Dhe në cilësinë e anëtarit të Grupet të hartimit të specifikimeve teknike dhe përlllogaritjes së fondit limit per vitin 2013-2014, për shkeljet e cilësuar për personat sipas nr.19 .

9. z.A.B, ky punonjës, i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “NIKA”, për procedurën e prokurimit: “Rikonstruksion i rrugëve “Parthineve dhe Shqipeve” me fond limit 23,092,897 lekë, të realizuara në vitin 2013, nuk ka argumentuar teknikisht dhe ligjërisht arsyet e s`kualifikimit të këtij operatori ekonomik ankues, në kundërshtim, me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe me VKM-së nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat Prokurimit Publik” i ndryshuar.

10. z. A.T, me cilësinë anëtarit e grupit të punës për rishikimin e dokumentacionit të procedurës së prokurimit për, “Rikonstruksion i rrugëve “Parthineve dhe Shqipeve” me fond limit 23,092,897 lekë, të përsëritur, të realizuar në vitin 2013, nuk ka analizuar shkaqet që shkaktuan dështimin e procedurës së parë dhe nuk ka bërë korrigjimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së dytë, në kundërshtim, me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe me, VKM-në nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat Prokurimit Publik” i ndryshuar. Po kështu me cilësinë Anëtarët të Komisionit të Llogaritjes së Fondit Limit të procedurës së prokurimit “Projekt Zbatim për Promenadën Bregdetare dhe Plazhin publik nga bërryli deri në Currila”, me fond limit 17,500,000 lekë, të realizuar në vitin 2013, ka llogaritur tarifën e projektimit (fondin

limit) më tepër në vlerën 18,330,400 lekë, në kundërshtim me VKM nr 444, datë 05.09.1994 “Për tarifat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të veprave të nderimit”.

11. z. B.S, me cilësinë anëtarit e grupit të punës për rishikimin e dokumentacionit të procedurës së prokurimit për, “Rikonstruksion i rrugëve “Parthineve dhe Shqipeve” me fond limit 23,092,897 lekë, të përsëritur, të realizuar në vitin 2013, nuk ka analizuar shkaqet që shkaktuan dështimin e procedurës së parë dhe nuk ka bërë korrigjimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së dytë, në kundërshtim, me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe me, VKM-në nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat Prokurimit Publik” i ndryshuar. Po kështu me cilësinë Anëtarët të Komisionit të Llogaritjes së Fondit Limit të procedurës së prokurimit “Projekt Zbatim për Promenadën Bregdetare dhe Plazhin publik nga bërri deri në Currila”, me fond limit 17,500,000 lekë, të realizuar në vitin 2013, ka llogaritur tarifën e projektimit (fondin limit) më tepër në vlerën 18,330,400 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 444, datë 05.09.1994 “Për tarifat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të veprave të nderimit”.

12. znj. M.S, kjo punonjëse me cilësinë anëtarit të grupit të punës për rishikimin e dokumentacionit të procedurës së prokurimit për, “Rikonstruksion i rrugëve “Parthineve dhe Shqipeve” me fond limit 23,092,897 lekë, të përsëritur, të realizuar në vitin 2013, nuk ka analizuar shkaqet që shkaktuan dështimin e procedurës së parë dhe nuk ka bërë korrigjimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së dytë, në kundërshtim, me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe me, VKM-në nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat Prokurimit Publik” i ndryshuar.

13. z.N.A, me cilësinë Anëtarët të Njesisë së Prokurimit;

14. z. A.K, me cilësinë Anëtarët të Njesisë së Prokurimit;

15. z. A.ZH, me cilësinë Anëtarët të Njesisë së Prokurimit në procedurën e prokurimit “ Blerje Ushqimesh ndarë me lote”, me fond limit 32,203,267 lekë, të realizuar në vitin 2013, nuk ka kërkuar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik ndryshimin (modifikimin) e dokumenteve të tenderit, në zbatim të VKM nr. 32 date 23.01.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 1 date 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik

16. z. A.Q, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe Drejtues i Këshillit Teknik pasi;

-me cilësinë Anëtarit të komisionit të llogaritjes së Fondit Limit të procedurës së prokurimit “Projekt Zbatim për Promenadën Bregdetare dhe Plazhin publik nga bërri deri në Currila”, me fond limit 17,500,000 lekë, të realizuar në vitin 2013, ka llogaritur tarifën e projektimit (fondin limit) më tepër në vlerën 18,330,400 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 444, datë 05.09.1994 “Për tarifat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të veprave të nderimit”.

-Për shkeljet në dhënien e lejeve zhvillimore dhe lejeve të përdorimit në kundërshtim me nenin 53 të ligjit nr. 10 119 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, e konstatuara në faqet 135-156 të Raportit Përfundimtar të aludimit dhe në *Procesverbalin nr. 25, datë 06.03.2015,*

17. z.A.T, me cilësinë e anëtarit të Grupet të hartimit të specifikimeve teknike dhe përlllogaritjes së fondit limit.

18. z.B.S me cilësinë e anëtarit të Grupet të hartimit të specifikimeve teknike dhe përlllogaritjes së fondit limit, pasi;

-në të gjitha rastet e audituara, në kërkesat teknike, kanë përcaktuar se, operatori ekonomik të ketë kategoritë e licencës lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës vetëm për kategorinë e punimit, pa përcaktuar klasifikimin e subjekteve juridik/fizik në nivele për çdo kategori punimesh në kundërshtim me VKM nr.42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pasi sipas kësaj rregullore, Kreu III, pika 1, “Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, garanci”, nën-pika “b”.

- në asnjë rast në preventivat e hartuar, nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 664, datë 26.9.12, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 514, datë 15.8.07, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10 , pasi nuk është

parashikuar zbatimin e VKM nr. 312, datë 05.05.10, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, aneksi VI, “Mbi sigurinë në kantier”, në vlerën jo më pak se 3% të vlerës së projektit.

- në hartimin e specifikimeve teknike për llogaritjen e fuqisë punëtore dhe nevojave për mjeteve makineri që duhet të paraqesin Operatorët Ekonomikë (OE) në tender, në asnjë rast nuk ka argumentim në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.07, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu III, “Dokumentet e Tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, nënpika “a”, “Kontratat për punë”.

- në llogaritjen e fondit limit rezultoi se: nuk janë respektuar manualët teknike të çmimeve, në kundërshtim me VKM nr.568, datë 27.6.13, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, VKM nr.514, datë 15.08.07, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pikat 10, 11, VKM nr. 664, datë 26.09.12, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 514, datë 15.8.07 të KM”, pikat 2, 3, 4, 5, 17, VKM nr.1, datë 10.01.07, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu III, “Dokumentet e Tenderit”, pika 3. Nga mosrespektimi i manualit teknik të çmimeve të ndërtimit, ka ndikim në llogaritjen e fondit limit: nën manual në shumën - 95.433.978 lekë, mbi manual në shumën + 52.691.235 lekë, e cila ka sjellë si pasojë hartimin dhe publikimin e fondit limit jo real.

- në kërkesat e specifikimeve teknike për realizimin e objektit: “Rikonstruksion i segmentit “Bulevardi Dyrrah–Sheshi Liria” dhe “Rikualifikim Fasdash” grupi i punës, nuk ka përcaktuar se çfarë certifikatash ISO duhet të paraqiten për prodhuesin, nga operatori ekonomik, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.06, ndryshuar, “Për prokurimin publik”, neni 23, “Specifikimet teknike”.

- Pasi në dokumentacionin për fillimin e punimeve nga kontraktori, “Eurondërtimi 2000” shpk për tre kontratat “Rikonstruksion i rruges “Tasim Kellici”, “Rikonstruksion i rruges “Porto Romano”, “Rikonstruksion rruge “Bajram Curri”, kanë vepruar në kundërshtim me: UKM nr.2, datë 13.5.05, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 2.1, dhe UKM nr 3, datë 15.2.01, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, kapitulli I, “Mbi mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit”, pika 5/a.

19. znj.E.S, pasi; me cilësinë e anëtarit të Grupet të hartimit të specifikimeve teknike dhe përlllogaritjes së fondit limit.

- në të gjitha rastet e audituara, në kërkesat teknike, kanë përcaktuar se, operatori ekonomik të ketë kategoritë e licencës lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës vetëm për kategorinë e punimit, pa përcaktuar klasifikimin e subjekteve juridik/fizik në nivele për çdo kategori punimesh në kundërshtim me VKM nr.42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pasi sipas kësaj rregullore, Kreu III, pika 1, “Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, garanci”, nënpika “b”.

- në asnjë rast në preventivat e hartuar, nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 664, datë 26.9.12, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 514, datë 15.8.07, “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 10, pasi nuk është parashikuar zbatimin e VKM nr. 312, datë 05.05.10, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, aneksi VI, “Mbi sigurinë në kantier”, në vlerën jo më pak se 3% të vlerës së projektit.

- në hartimin e specifikimeve teknike për llogaritjen e fuqisë punëtore dhe nevojave për mjeteve makineri që duhet të paraqesin Operatorët Ekonomikë (OE) në tender, në asnjë rast nuk ka argumentim në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.07, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu III, “Dokumentet e Tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta”, nënpika “a”, “Kontratat për punë”.

- në llogaritjen e fondit limit rezultoi se: nuk janë respektuar manualët teknike të çmimeve, në kundërshtim me VKM nr.568, datë 27.6.13, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, VKM nr.514, datë 15.08.07, “Për

informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pikat 10, 11, VKM nr. 664, datë 26.09.12, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 514, datë 15.8.07 të KM”, pikat 2, 3, 4, 5, 17, VKM nr.1, datë 10.01.07, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu III, “Dokumentet e Tenderit”, pika 3. Nga mosrespektimi i manualit teknik të çmimeve të ndërtimit, ka ndikim në llogaritjen e fondit limit: nën manual në shumën - 95.433.978 lekë, mbi manual në shumën + 52.691.235 lekë, e cila ka sjellë si pasojë hartimin dhe publikimin e fondit limit jo real.

- në kërkesat e specifikimeve teknike për realizimin e objektit: “Rikonstruksion i segmentit “Bulevardi Dyrrah – Sheshi Liria” dhe “Rikualifikim Fasdash” grupi i punës, nuk ka përcaktuar se çfarë certifikatash ISO duhet të paraqiten për prodhuesin, nga operatori ekonomik, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.06, ndryshuar, “Për prokurimin publik”, neni 23, “Specifikimet teknike”.

20. z. A.D., në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për procedurën e prokurimit

-**“Rikonstruksion i segmentit “Bulevardi Dyrrah – Sheshi Liria”**, Fondi limit 56.328.000 lekë, oferta e OE “Eurondërtimi 2000”shpk & “Everest”shpk nuk është e vlefshme dhe KVO, duhej të anulonte tenderin, pasi asnjë nga OE nuk ka paraqitur dokumentacion sipas kërkesave të DT. Efekti ekonomik negativ nga zhvillimi i kësaj procedure është 14.505.444 lekë (diferenca midis OE me vlerë më të ulët “A.....Impex” shpk & “G.....”shpk & “Ndrekaj” shpk 37.440.471 lekë–ofertën e BOE “E..... 2000” shpk & “E.....”shpk 51.945.915 lekë.

21. z. D.A., në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për procedurën e prokurimit **“Rikonstruksion i segmentit “Bulevardi Dyrrah – Sheshi Liria”**, Fondi limit 56.328.000 lekë, oferta e OE “Eurondërtimi 2000”shpk & “Everest”shpk nuk është e vlefshme dhe KVO, duhej të anulonte tenderin, pasi asnjë nga OE nuk ka paraqitur dokumentacion sipas kërkesave të DT. Efekti ekonomik negativ nga zhvillimi i kësaj procedure është 14.505.444 lekë (diferenca midis OE me vlerë më të ulët “A....I” shpk & “G.....”shpk & “N.....” shpk 37.440.471 lekë–ofertën e BOE “E.....shpk & “E.....”shpk 51.945.915 lekë.

22. znj. A.P në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për procedurën e prokurimit për tenderin **“Rikualifikim Fasdash”**, me fond limit **28.327.000** lekë

Për mosanulimin e procedurës së prokurimit, dhe për kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Bean” shpk, pasi nga auditimi rezultoi se të gjithë OE nuk plotësonin kriterete e vecanta e të përgjithshme për kualifikim me **efekt ekonomik negativ 7.099.402 lekë.**

- Nga auditimi i procedurave të prokurimit, Rikonstruksion rruge “Polumbari” dhe Rikonstruksion rruge “Durrësi ne shekuj” të zhvilluara në të njëjtën datë, orë të ndryshme, në të cilat KVO, ka klasifikuar dhe më vonë janë lidhur kontrata me të njëjtin BOE, “Çaushti”shpk & “Varaku E”shpk, i cili ka paraqitur të njëjtat makineri për kryerjen e punimeve, në dy objekte të ndryshme, me të njëjtin afat kohor, grafik punimesh., duke moszbatuar VKM nr. 1, datë 10.01.07, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”, pika 4, “Hapja dhe vlerësimi i ofertave”, pika “ç”.

23. znj. D.I në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për procedurën e prokurimit **“Rikualifikim Fasdash”**, me fond limit **28.327.000** lekë

- Për mosanulimin e procedurës së prokurimit, dhe për kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Bean” shpk, pasi nga auditimi rezultoi se të gjithë OE nuk plotësonin kriterete e vecanta e të përgjithshme për kualifikim me **efekt ekonomik negativ 7.099.402 lekë.**

- Dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit të marrjes në dorëzim për shkeljet e cilësuar për personat sipas nr.26, 27 dhe nr.28.

24. znj. A.Q në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për procedurën e prokurimit

Në tenderin e zhvilluar me objekt: “Blerje Gaz për sobë gatimi”, me fond limit 2.553.600 lekë, nisur nga gjetjet e konstatuara të dy OE nuk i plotësojnë kriteret e kualifikimit dhe ky tender duhej të anulohet. Efekti ekonomik negativ i procedurës është oferta e “S...”shpk me marzh fitimi 19

lek/kg dhe me vlere 1.967.465 leke pa tvsh - oferta e "SCo"shpk me marzh fitimi 35 lek/kg dhe me vlere 2.236.265 leke = 268.800 lekë.

25. znj.A. H. në cilësinë e anëtarit të KVO-së,

Nga auditimi i procedurave të prokurimit, *Rikonstruksion rruge "Polumbari" dhe Rikonstruksion rruge "Durrësi ne shekuj"* të zhvilluara në të njëjtën datë, orë të ndryshme, në të cilat KVO, ka klasifikuar dhe më vonë janë lidhur kontrata me të njëjtin BOE, "Ç....i"shpk & "V.. shpk, i cili ka paraqitur të njëjtat makineri për kryerjen e punimeve, në dy objekte të ndryshme, me të njëjtin afat kohor, grafik punimesh., duke moszbatuar VKM nr. 1, datë 10.01.07, "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar Kreu V, "Zhvillimi i procedurave", pika 4, "Hapja dhe vlerësimi i ofertave", pika ".

26. z. E L në cilësinë e antarit të komisionit të marrjes në dorëzim ,

27. znj. E. M, në cilësinë e antarit të komisionit të marrjes në dorëzim

28. znj.R.K, në cilësinë e antarit të komisionit të marrjes në dorëzim,

Në zbatimin e procedurave të marrjes në dorëzim të "Studim dhe projektim për rikualifikim i nënkalimit dhe rotundos tek ura e Dajlanit dhe në plepa, si dhe studimi për trafikun rrugor", ka rezultuar se:

- Dosja e dorëzuar nga kontraktori "SPHAERA" shpk, dhe e marrë në dorëzim nga ky grup nuk është e inventarizuar dhe numerizuar, në kundërshtim me ligjin nr.9154, datë 06.11.03 "Për Arkivat" dhe aktet ligjore në zbatim të tij. Në dokumentet pjesë e kësaj dosje me titull, "Lista e dokumenteve të paraqitur", e cila është pa datë, vulë e firmë të kontraktorit, rezulton se janë paraqitur, pa numër faqesh: dhe me një istë vetëm me nënzëra nën zëra, në kundërshtim me përcaktimin në nenin 4/26, të ligjit 10296, datë 08.07.10 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave (UMF) nr. 30, datë 27.12.11, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kreu III, "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", pika 36.

- Në dosje nuk janë analizat teknike të çmimeve, ato nuk janë paraqitur nga kontraktuesi, (nuk përfshihen as në listën e dokumenteve të paraqitur nga kontraktori), si dhe nuk ndodheshin në dosje, në kundërshtim me kontratën e lidhur midis palëve, nenet: 2, "Përbërja e kontratës", pika 2.1, neni 6, "Afati i dorëzimit të projektit", pika 6.3, neni 9, "Të drejtat dhe detyrimet e kontraktuesit", pika 9.1 dhe aneks kontrata, "Termet e referencës".

- Nga ana e shoqërisë "SPHAERA" shpk, nuk janë përcaktuar dhe argumentuar kategoritë e licencës, llojet e makinerive si dhe numri i fuqisë punëtore që duhet për realizimin e objektit.

29. znj. E.K, me detyrë Shefe e Sektorit të Urbanistikës Ligjore dhe Marrëdhëniet me Publikun Për shkeljet në dhënie e lejeve zhvillimore dhe lejeve të përdorimit në kundërshtim me nenin 53 të ligjit nr. 10 119 "*Për planifikimin e territorit*", të ndryshuar, e konstatuara në faqet 135-156 të Raportit Përfundimtar të aludimit dhe në *Procesverbalin nr. 25, datë 06.03.2015*,

30. z. A.Ç. me detyrë Kryeinspektor i IMTV ish-INUV Bashkia Durrës

- për 41 raste vendimesh të pa ekzekutuara për prishje punimesh pa leje me dhe pa pasojë krijimin e shtesave në sipërfaqe e vëllim ndërtimor, paraqitur në Aneksin 02, Tabela 01 (nr. 36-71) dhe Tabela 02, për të cilat në kundërshtim me VKM nr. 862, datë 5.12.2007, të ndryshuar, pika 8, me nenin 47 të ligjit nr. 10 433, datë 16.6.2011 "*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*" me nenin 82, pika 8, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "*Për Planifikimin e Territorit*", të ndryshuar dhe me nenin 52, pika 1 e), të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*" nuk janë vendosur gjokat përkatëse sipas rastit, duke shkaktuar të ardhura të munguara në buxhetin e njësisë vendore në vlerën 6,500,000 lekë.

31. Për z. L.B, me detyrë Shef i Kabinetit,

32. Për znj.J.R, me detyrë Drejtore e drejtorisë Tatim Taksave,

33. Për znj E.R me detyrë Drejtore Drejtorisë ligjore,

34. Për z. B.K, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Shërbimeve,

35. Për z. S.K, me detyrë Drejtor i Politikave të Zhvillimit,

36. Për z. A.G, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Amësim Kulturë, rinisë e Sportit,

37. Për. znj. M.Xh, me detyrë Drejtore e Shërbimit Social, dhe të gjithë dhe me cilësinë e Grupi Menaxhimit Strategjik ngritur me urdhrin nr. 38, datë 18.4.2013,

Për mangësitë dhe mosveprimet lidhur me plotësimin e pyetësorit të vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2012 dhe për mospërmblidhjen e detyrimeve, gjatë vitit 2013, lidhur me zbatimin dhe implementimin e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” me mos funksionimin e strukturave, në kundërshtim me nenet 19,20, 21,dhe 22 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe nenin 66 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, trajtuar në faqet 16-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

38. znj. M. L, me detyrë inventarizuese pranë Sektorit të Financës për mungesën e vendosjes së mekanizmave të kontrollit të brendshëm lidhur me administrimin, rakordimin, kontrollin e blloqeve të Fletë Gjobave, inventarizimin dhe vjeljen e derdhjen në kohë të fletë gjobave të vendosura, mosveprime në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”,trajtuar hollësisht në faqet 165-169 të Raportit përfundimtar të Auditimit.

D. MASA ADMINISTRATIVE

c. 1. Për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore të Bashkisë Durrës

Mbështetur në nenin 5/b të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014 dhe nenin 15 “Sanksionet”, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, i propozojmë:

Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore të Bashkisë Durrës, që ka në juridiksion territorin ku ndodhen objektet e trajtuara sipas kontratave, që të vlerësojë shkeljet e konstatuara,që janë pasqyruar në raportin përfundimtar të, duke vendosur sanksionet si më poshtë:

Dënimin me gjobë, për 2 mbikëqyrës të punimeve të ndërtimit dhe 1 kolaudator të punimeve të ndërtimit respektivisht:

1. Për subjektet “S.....”, me licencë me nr. MK 1859/2 dhe subjekti “Z...-06”, përfaqësuar nga ing. E.Sh me të cilin është lidhur kontrata e shërbimit me nr. 4254, datë 04.08.2011, me vlerë të përcaktuar 6.003.360 lekë, pa TVSH, për mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit për objektin “*Ndërtim i Shkollës së Mesme, lagja “Ish Kënetë”, Bashkia Durrës*, për shkak se:

-Punimet e ndërtimit nuk janë zbatuar në përputhje me kushtet teknike të projektimit e të zbatimit dhe librezat e masave për përshkrimin e punimeve sipas grafikut dhe projekt zbatimit, nuk pasqyron me vërtetësi punimet e kryera për të përcaktuar saktë volumet e punimeve. Si rezultat i situacionimit të tre zëra punimesh, me diferenca volumesh të pa kryera në vlerën **1,307,268 lekë pa TVSh**, ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga bashkimi i operatorëve ekonomik “A...” sh.p.k. dhe “F sh.p.k. . Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001”Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, Autoriteti Kontraktor me shkresën nr. 2434/1, datë 06.06.2013 ,ka caktuar subjektin “M.....” sh.p.k. ,

2. Për subjektin “M.....” sh.p.k. , përfaqësuar nga ing. T.S, të cilin Autoriteti Kontraktor me shkresën nr. 2434/1, datë 06.06.2013, e ka caktuar koaludator të punimeve të ndërtimit për objektin “*Ndërtim i Shkollës së Mesme, lagja “Ish Kënetë”, Bashkia Durrës*”, për shkak se:

- Gjatë kolaudimit të punimeve të ndërtimit, nuk ka verifikuar me përgjegjësi realizimin e objektit në përputhje me projektin, pasi përmasat që pasqyrohen në skicat e projektit, nuk janë të njëjta me ato të pasqyruara në librezën e masave, për rrjedhojë janë rritur sasitë e volumeve të situacionuar për tre zëra punimi dhe ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga bashkimi i operatorëve ekonomi “A....” sh.p.k. dhe “F...” sh.p.k. . Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me pikën 3, Udhëzimi i KM nr. 3, datë 15.02.2001 ”Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar.

3. Për z. S.H, mbikëqyrës i punimeve, me licencë nr. MK 0952/4, me të cilin është lidhur kontrata e shërbimit me nr. 892, datë 12.02.2013, me vlerë të përcaktuar 508,320 lekë, për mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit për objektin “*Rikonstruksion të Kuartallit Lagja 18 faza e II*” Bashkia Durrës, për shkak se:

a-Punimet e ndërtimit nuk janë zbatuar në përputhje me kushtet teknike të projektimit e të zbatimit dhe librezat e masave për përshkrimin e punimeve sipas grafikut dhe projekt zbatimit, nuk pasqyron me vërtetësi punimet e kryera për të përcaktuar saktë volumet e punimeve. Si rezultat i situacionimit të shtatë zëra punimesh, me diferenca volumesh të pa kryera në vlerën **484,330 lekë pa TVSh**, ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga operatori ekonomik “V...” sh.p.k. .

b- Janë përdorur materiale për ndërtimin e objektit, që nuk janë në përputhje me standardet e kërkuara dhe nuk janë kryer në masën e duhur testimet dhe provat laboratorike të këtyre materialeve të vendosura në objekt.

Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe me pikën 9, pikën 10 dhe 14, të Udhëzimit nr. 3, datë 15.02.2001”Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar.

Nga Bashkia Durrës, me shkresë nr. 5666/1, prot, datë 29.07.2015, protokolluar në KLSH me nr.1206/9 datë 30.0.2015 dhe nr.1206/10, datë 04.08.2015, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar plotësisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Selfo Zeneli, Bashkim Harizi, Lolita Baholli, Enejda Serja, Qemal Shehu dhe Luan Kuka, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT